



EDICION SPECIAL

Nr. 1/14 – Korrik 2014

KOSOVA DREJT BE-SË: BAROMETRI I SUNDIMIT TË LIGJIT

www.kipred.org

Ky Projekt mbështetet nga Komisioni Evropian, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.



Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim i takojnë KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Përpiluar nga: Ariana Qosaj – Mustafa, Violeta Haxholli dhe Njomza Sejdullahu

Hulumtimi është mbështetur nga: Vlora Gaxherri

E drejta autoriale © 2014 KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem ruajtës apo të transmetohet në ndonjë formë apo me anë të ndonjë mjeti, qoftë elektronik, mekanik, fotokopjim, incizues apo të tjera, pa lejen paraprake të publikuesit. Luteni të kontaktoni info@kipred.org apo +381 38 227 778.

Publikuar nga:



Instituti Kosovar për Kërkim dhe Zhvillim të Politikave
Rr. Abdyl Frashëri, Nr. 44
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 227 778
www.kipred.org



Syri i Vizionit
Isa Demaj, No. 14 30000
Peja/Pec, Kosovo
Tel: +381 (0) 39 423 240
www.syriivizionit.org

Përmbajtje

| | | |
|------|---|----|
| I. | Demokracia, Funkcionimi i Institucioneve Demokratike dhe Sundimi i Ligjit | 3 |
| II. | Parandalimi dhe Luftimi i Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit | 10 |
| III. | Menaxhimi i Kufijve në lidhje me Krimin e Organizuar, duke përfshirë Migracionin e Parregullt dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore..... | 36 |
| IV. | Bashkëpunimi në Zbatimin e Ligjit..... | 48 |
| V. | Sistemi Gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar) | 58 |
| VI. | Luftimi i Pastrimit të Parave | 84 |

Treguesit e paraqitur në këtë raport janë marrë nga raportet e Progresit të BE-së, Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave me Kosovën, dhe monitorimi i projektit. Të dhënat e paraqitura këtu janë gjithashtu në dispozicion në faqen e internetit të projektit "Kosova drejt BE-së: Barometri i Sundimi të Ligjit": <http://kosovo-eubarometer.com/sq/projekti> Barometri është një mjet për të vlerësuar dhe monitoruar përmbushjen e kritereve të BE-së nga institucionet e Kosovës, përmes zhvillimit të treguesve objektivë, faktikë dhe të matshëm.

I. Demokracia, Funksonimi i Institucioneve Demokratike dhe Sundimi i Ligjit

| Fusha | Veprimet që duhet të ndërmerren (Treguesit) | Çfarë është bërë deri më tani? Treguesit janë marrë nga raportet e progresit të BE-së dhe Udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave për Kosovën, dhe nga monitorimi ynë në kuadër të këtij projekti | Çfarë duhet bërë më tutje/Rekomandimet |
|--|---|--|---|
| <p>1) Demokracia, funksionimi demokratik i institucioneve dhe Sundimi i Ligjit;</p> | <p>1. 1. Qeveria, në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin, ende duhet të përmirësojë kapacitetet e saj për verifikimin dhe konfirmimin e përputhshmërisë së legjislacionit me <i>acquis</i>;</p> | <p>1.1 (a) Në disa fusha të politikave, legjislacioni ekzistues tashmë është në përputhshmëri me elementet thelbësore të <i>acquis</i> së Bashkimit Evropian (BE);</p> <p>1.1 (b) Qeveria ka përmirësuar përputhshmërinë me rregullat e procedurës. Janë prezentuar Tabelat e Pajtueshmërisë me <i>acquis</i> dhe disa koncept letra, të cilat nga BE janë konsideruar si hap përpara;</p> <p>1.1 (c) Ministria e Integritimit Evropian (MIE) ka hartuar Rregulloren Nr. 02/2015 për procesin e përkthimit të <i>acquis</i> të BE-së në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Përmes kësaj rregulloreje, MIE parashikon harmonizimin e procesit të përkthimit të <i>acquis</i>, duke unifikuar të gjitha procedurat, format, si dhe terminologjinë e legjislacionit. Kjo rregullore ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2015;</p> <p>1.1 (d) Në vitin 2013, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar 64 projektligje dhe 66 akte nënligjore. Përsa i përket përafrimit ligjor, Ministria e Integritimit Evropian ka vlerësuar gjithsej 87 akte ligjore dhe nënligjore për përputhje me <i>acquis</i>, ose 67%, dhe nga ana tjetër ka dhënë opinione</p> | <p>1.1 (b) Njohja me Tabelat e Pajtueshmërisë me <i>acquis</i> dhe koncept letrave paraqesin një hap përpara, dhe duhet të përdoren sistematikisht, duke përfshirë pasqyrat financiare; Projektligjet dhe amendamentet në legjislacion kanë nevojë për shqyrtim më të mirë, në mënyrë që të sigurohet harmonizimi i ligjeve me <i>acquis</i>-në e BE-së, duke përkthyer <i>acquis</i>-në, dhe duke unifikuar të gjitha procedurat, format si dhe terminologjinë e legjislacionit;</p> <p>1.1 (c) Ministria e Integritimit Evropian duhet të fillojë zbatimin e Rregullores Nr. 02/2015 për procesin e përkthimit të <i>acquis</i> së BE-së sa më shpejtë që është e mundur;</p> |

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | <p>ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> <p>1.1 (e) Një grup prej tetëmbëdhjetë (18) personave nga institucione të nivelit qendror dhe lokal, kanë marrë pjesë aktivisht në “Trajnimin e Trajnerëve (TeT) për Harmonizim Ligjor dhe përdorimin e tabelave të pajtueshmërisë”, dhe janë certifikuar më 14 maj 2014. Në qershor të vitit 2014, seanca e parë e trajnimit për zyrtarët e institucioneve publike përkatëse ka filluar zyrtarisht;</p> <p>1.1 (f) Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në qershor të vitit 2014, ka hartuar një fjalor të terminologjisë themelore lidhur me procesin e integrimi evropiane dhe dokumentin mbi harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e BE-së;</p> <p>1.1 (g) Tre (3) zyrtarë të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) janë trajnuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP) në përfrimin e legjislacionit me <i>acquis</i>; Të dhënat për ministrinë e tjera mungojnë. Do të përditësohen në përputhje me rrethanat;</p> | <p>1.1 (d) Ministria e Integritit Evropian duhet të sigurojë që të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore janë vlerësuar për përputhshmërinë me <i>acquis</i> Është i nevojshëm shqyrtim më i mirë i projekt-ligjeve ashtu që të sigurohet harmonizimi me <i>acquis</i>;</p> <p>1.1 (e) Sipas nevojës, Ministria e Integritit Evropian duhet të kryejë trajnime të tjera për zyrtarët përkatës publikë në lidhje me Harmonizimin Ligjor dhe përdorimin e tabelave të pajtueshmërisë, në mënyrë që të sigurohet kuptimi më i shpejtë dhe miratimi i <i>acquis</i> të BE-së;</p> <p>1.1 (g) Qeveria duhet të sigurohet që të gjithë zyrtarët përkatës publikë që punojnë në harmonizimin dhe miratimin e <i>acquis</i> së BE-së duhet të marrin pjesë në trajnime mbi këtë temë, për të siguruar një adoptim më të mirë dhe më efikas të <i>acquis</i>;</p> |
| <p>1) Demokracia, funksionimi demokratik i institucioneve dhe Sundimi i Ligjit;</p> | <p>1.2. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit, përgjegjshmërisë dhe transparencës së qeverisë,</p> | <p>1.2 (a) Qeveria e Kosovës ka rritur kapacitetin e saj për të adresuar prioritetet e procesit të integritit evropian dhe mbetet e përkushtuar në dialogun e lehtësuar nga BE-ja me Serbinë;</p> | <p>1.2 (a) Qeveria e Kosovës duhet të përpiqet më shumë për adresimin e kritereve të theksuara në studimin e fizibilitetit dhe Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), të</p> |

| | | | |
|--|---|---|--|
| | <p>duke përfshirë nivelin komunal;</p> | <p>1.2 (b) Janë ndërmarrë hapa për të përmirësuar mbikëqyrjen e Kuvendit ndaj qeverisë, përfaqesjen e planeve legjislative në mes të Kuvendit dhe qeverisë. Kuvendi ka ndërmarrë aktivitete për të shqyrtuar punën e qeverisë, veçanërisht në lidhje me rezultatet e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë;</p> <p>1.2 (c) Nga 1 maji deri më 31 korrik, Qeveria i ka paraqitur gjashtë (6) raporte me shkrim Komisionit për Siguri të Kuvendit të Kosovës. Komisionet e Kuvendit kanë nisur monitorimin e zbatimit të trembëdhjetë (13) ligjeve dhe planeve për të shqyrtuar tridhjetë (30) raporte të paraqitura nga institucionet e pavarura;</p> <p>1.2 (d) Transparenca e buxhetit është përmirësuar më tej, dhe Ministria e Financave (MF) ka filluar botimin e informacionit tremujor mbi nivelin e borxhit të qeverisë dhe strukturën në ueb-faqen e saj;</p> | <p>nënshkruar kohëve të fundit;</p> <p>1.2 (b) Qeveria ende duhet të punojë në zhvillimin e kapaciteteve për zbatimin e prioriteteve të nivelit afatmesëm dhe afatgjatë, nga studimi i fizibilitetit dhe nga Marrëveshja e e Stabilizim Asociimit, të nënshkruar kohëve të fundit;</p> <p>1.2 (c) Të gjitha institucionet e Kosovës duhet të përmbushin detyrimin e tyre për zbatimin e plotë të legjislacionit;</p> <p>1.2 (d) Qeveria duhet të sigurojë pjesëmarrjen e duhur në punën e Kuvendit; Mbikëqyrja e qeverisë duhet të përmirësohet, duke përfshirë përcjelljen e rekomandimeve të komisioneve tek ministritë, për të siguruar që rekomandimet e bëra nga komisionet janë adresuar dhe, kur është parë e përshtatshme, janë miratuar;</p> |
| <p>1) Demokracia, funksionimi demokratik i institucioneve dhe Sundimi i Ligjit;</p> | <p>1.3. Ministritë duhet të përmirësojnë përcjelljen e kërkesave të komisioneve parlamentare, duke përfshirë raportimin e ministrive për përmbushjen e kërkesave për liberalizimin e vizave;</p> | <p>1.3 (a) Anëtarët e qeverisë ende nuk kanë arritur të ndjekin seancat për pyetje parlamentare apo mbledhjet përkatëse të komisioneve parlamentare; Praktika e ministrave që u raportojnë komisioneve të Kuvendit është në rritje. Poashtu, numri i stafit që mbështesin komisionet është rritur. Kuvendi ka</p> | <p>1.3 (a) Anëtarët e qeverisë duhet të marrin pjesë në të gjitha seancat për pyetje parlamentare apo mbledhjet përkatëse të komisioneve parlamentare; Kuvendi duhet të zhvillojë më tej standardet për konsultim publik dhe komisionet e saj duhet t'i</p> |

| | | | |
|--|--|--|---|
| | | <p>rritur numrin e konsultimeve me shoqërinë civile, si dhe me publikun përmes dëgjimeve;</p> <p>1.3 (b) Në lidhje me aktivitetet e ndërmarra për bashkërendimin e planifikimit strategjik, përkatësisht mbikëqyrjen e procesit të hartimit të strategjive të parapara në Planin Vjetor 2014 për Dokumentet Strategjike (APSD), Zyra e Planifikimit Strategjik ka dhënë udhëzime dhe mbështetje me qëllim të përmbushjes së APSD-së së vitit 2014. Fillimisht, Qeveria kishte planifikuar hartimin dhe miratimin e tetëmbëdhjetë (18) dokumenteve strategjike gjatë gjysmës së parë të vitit 2014; megjithatë, nga shtatë (7) dokumente strategjike që janë miratuar gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, katër (4) janë parashikuar dhe përfshirë në APSD-në e vitit 2014 dhe vetëm tri (3) dokumente strategjike janë miratuar nga 1 maji deri më 31 korrik 2014;</p> <p>1.3 (c) Më 28 gusht 2014, Sekretariati i Kosovës për Liberalizimin e Vizave ka hartuar një plan për adresimin e rekomandimeve që dalin nga raporti i Komisionit. Plani është hartuar në bashkëpunim me të gjitha institucionet zbatuese të përfshira dhe fokusohet në masat konkrete që do të ndërmerren në gjysmën e dytë të vitit 2014;</p> <p>1.3 (d) Siç është raportuar nga zyrtarët e qeverisë, bashkërendimi ndërmjet komisioneve të Kuvendit</p> | <p>aplikojnë ato vazhdimisht gjatë kryerjes së dëgjimeve;</p> <p>Komunikimi i mirë me Kuvendin, duke përfshirë edhe përgjigjet e rregullta të qeverisë ndaj pyetjeve parlamentare si dhe bashkërendimin e fortë ndër-ministor, është faktor kyç në këtë drejtim;</p> <p>1.3 (b) Të gjitha dokumentet strategjike duhet të jenë në përputhje me planifikimin vjetor të ministrive;</p> <p>1.3 (c) Të gjitha institucionet e Kosovës duhet të rrisin përpjekjet e tyre për të përmbushur sa më parë të gjitha kriteret që dalin nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave. Kuvendi dhe qeveria e re duhet të krijohen sa më parë që është e mundur, në mënyrë që të mos vonohet zbatimi i kërkesave të BE-së për studimin e fizibilitetit dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së ardhshme për Stabilizim dhe Asociim (MSA);</p> <p>1.3 (d) Bashkërendimi në mes të komisioneve parlamentare dhe ministrive duhet të përmirësohet më tej në këtë legjislaturë;</p> <p>1.3 (e) Kuvendi i Kosovës duhet të publikojë me kohë në uebfaqen zyrtare të saj të gjitha procesverbalet e komisioneve parlamentare,</p> |
|--|--|--|---|

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>dhe ministrive në legjislaturën e kaluar ishte i mirë. Nuk ka pasur problem si dhe komisionet u kanë dhënë ministrive informacionin e nevojshëm si dhe anasjelltas;</p> <p>1.3 (e) Kuvendi ka rishikuar rregullisht raportet e komisioneve mbi zbatimin e ligjeve dhe rekomandimet e miratuara për të përmirësuar implementimin;</p> | <p>duke përfshirë edhe transkriptet e seancave plenare;</p> |
| <p>1) Demokracia, funksionimi demokratik i institucioneve dhe Sundimi i Ligjit;</p> | <p>1.4. Kuvendi dhe institucionet e saj duhet të përqëndrohen në prioritetet e identifikuara në studimin e fizibilitetit, duke përfshirë funksionet e mbikëqyrjes dhe kontrollit;</p> | <p>1.4 (a) Pas rekomandimeve të studimit të fizibilitetit, Kuvendi ka modifikuar nenet e Kodit Penal për përgjegjësinë penale të mediave dhe mbrojtjen e burimeve të gazetareve. Marrëveshja Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Misionit të Ligjit në Kosovë (EULEX), së bashku me Ligjin për ndryshimin e ligjeve që lidhen me mandatin e EULEX-it, janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës në prill të vitit 2014;</p> <p>1.4 (b) Në fushën e reformës zgjedhore, Kuvendi i Kosovës e ka ndryshuar Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Më 3 prill 2014, ky projektligj u miratua në leximin e parë të Kuvendit;</p> <p>1.4 (c) Lidhur me pavarësinë financiare dhe administrative të Kuvendit, siç theksohet në studimin e fizibilitetit, në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nuk ka dispozita që detyrojnë Ministrinë e Financave, përkatësisht Qeverinë, për të kërkuar mendimin e Kuvendit gjatë shqyrtimit të kërkesave financiare të organizatave buxhetore apo të vetë kërkesës buxhetore të Kuvendit. Megjithatë, gjatë fazës së</p> | <p>1.4 (a) Kuvendi duhet të miratojë Ligjin për kundërvajtje, i cili është i rëndësishëm pasi që do ta shkarkojë volumin e rasteve gjyqësore, duke instaluar mekanizmat e shqyrtimit brenda institucioneve, të cilat fillojnë procedurat për kundërvajtje në gjykatë;</p> <p>1.4 (b) Sipas prioriteteve të identifikuara në studimin e fizibilitetit në lidhje me reformën zgjedhore, Kuvendi dhe institucionet e tjera të autorizuara duhet të përfundojnë pjesën tjetër të reformës zgjedhore sa më shpejt që është e mundur;</p> <p>1.4 (c) Pas prioriteteve të identifikuara në studimin e fizibilitetit, ndryshimet legjislative që lidhen me çështjen e projekt-buxhetit të Kuvendit të Kosovës, duke përfshirë pagat dhe shpërblimet për stafin e administratës së Kuvendit duhet të iniciohen, ashtu që të krijohet pavarësia</p> |

| | | | |
|--|--|--|---|
| | | <p>dëgjimeve buxhetore, Ministria e Financave gjithmonë fton Komisionin për Buxhet dhe Financa të Kuvendit për të marrë pjesë në të gjitha seancat buxhetore. Komisioni për Buxhet dhe Financa vlerëson se deri sa nuk ka ndryshime legjislative, shqyrtimi dhe miratimi i projekt-buxhetit të Kuvendit të Kosovës, duke përfshirë pagat dhe shpërblimet për stafin e administratës së Kuvendit (por edhe të organizatave të tjera buxhetore), duhet të kryhet në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, përkatësisht Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Rregullores mbi Orarin e punës dhe shpërblimet për Shërbyesit Civil të Administratës së Kuvendit;</p> <p>1.4 (d) Kuvendi i Republikës së Kosovës ka një kornizë kushtetuese dhe ligjore me mandat të qartë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit dhe politikave ekzekutive. Ky mandat është në masë të madhe i matur dhe i ushtruar nëpërmjet komisioneve të përhershme dhe funksionale. Në përputhje me këtë mandat dhe detyrimet që rrjedhin nga veprimet e planifikuara në agjendën e integritimeve, Kuvendi ka rritur mbikëqyrjen e ekzekutivit duke monitoruar zbatimin e ligjeve dhe politikave të qeverisë;</p> <p>1.4 (e) Kuvendi e ka rritur numrin e debateve parlamentare dhe interpelancave të ministrave; Qeveria ka një komunikim të mirë me Kuvendin, duke përfshirë përgjigjet e rregullta të pyetjeve</p> | <p>financiare dhe administrative e Kuvendit;</p> <p>1.4 (e) Kuvendi duhet të rrisë edhe më tej rolin e tij mbikëqyrës të qeverisë duke rritur numrin e debateve tematike parlamentare dhe interpelancave të ministrave;</p> <p>1.4 (p) Kuvendi duhet të mbikëqyrë më për së afërmi institucionet e pavarura, autoritetet rregullatore dhe agjencitë, në bazë të një mandati të qartë dhe me mekanizma të përshtatshme të raportimit dhe llogaridhënies. Gjithashtu, emërimet e vonuara në përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve të këtyre institucioneve dhe organeve duhet të bëhen në bazë të kualifikimeve profesionale dhe meritës, dhe jo patronazhit politik;</p> <p>1.4 (e) Kuvendi duhet të rrisë vazhdimisht rolin e tij mbikëqyrës ndaj qeverisë. Kuvendi duhet të përmirësojë mbikëqyrjen ndaj kompanive publike, institucioneve të pavarura dhe autoriteteve rregullative;</p> |
|--|--|--|---|

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>parlamentare dhe koordinim të fortë ndër-ministror;</p> <p>1.4 (p) Kuvendi ka shtyrë emërimin e anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura, autoriteteve rregullative dhe agjencive. Si pasojë e kësaj, këto institucione dhe autoritete janë pothuajse jofunksionale;</p> <p>1.4 (f) Kuvendi ka ndërmarrë aktivitete për të shqyrtuar punën e qeverisë, veçanërisht në lidhje me rezultatet e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë; Megjithatë, edhe pse mbikëqyrja e punës së Qeverisë nga ana e Kuvendit është rritur, rezultatet kanë qenë minimale;</p> <p>1.4 (g) Kuvendi ka përparuar në mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe konsultimin me shoqërinë civile. Përveç kësaj, Kuvendi ka rekrutuar një zyrtar ndërlidhës nga rradhët e OJQ-ve, në mënyrë që të rrisë bashkëpunimin me shoqërinë civile. Për sa i përket qeverisë, është bërë progres në përmirësimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile;</p> <p>1.4 (f) Legjislatura e pestë, e konstituar në dhjetor të vitit 2014, deri në fillim të nëntorit 2015, ka miratuar 31 ligje, ndërsa 34 ligje janë në procedurë;</p> <p>1.4 (g) Kuvendi miratoi me sukses ndryshimet kushtetuese dhe legjislacionit të nevojshëm për krijimin e Dhomave të Specializuara dhe Prokurorisë së Specializuar për të hetuar akuzat për krime ndërkombëtare të kryera gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999;</p> <p>1.4 (i) Disa ligje të rëndësishme, duke përfshirë edhe ato mbi gjyqësorin dhe të drejtat e njeriut,</p> | <p>1.4 (f) Të gjithë ministrat e qeverisë duhet të japin llogari/përgjegjësi para kuvendit, duke ndjekur debatet parlamentare dhe interpelancat në lidhje me temat përkatëse të fushëveprimit të tyre;</p> <p>1.4 (g) Pas konstituimit, Kuvendi i ri duhet të vlerësojë punën e qeverisë, në veçanti marrëveshjet e reja që kanë rezultuar nga dialogu Kosovë-Serbi. Në veçanti, duhet të fokusohet gjatë kohës kur Kuvendi nuk ishte funksional, si pasojë e procesit zgjedhor;</p> <p>1.4 (g) Kuvendi duhet të forcojë mbikëqyrjen e saj të procesit legjislativ dhe ekzekutiv dhe të zbatojë standardet për konsultime me shoqërinë civile. Të dhëna nga shoqëria civile duhet të kërkohen në mënyrë sistematike dhe të ketë follow-up nga qeveria. Strategjia e qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile duhet të zbatohet plotësisht dhe të monitorohet në mënyrë efektive;</p> <p>1.4 (f) Legjislatura e pestë e Kuvendit të Kosovës duhet të vënë edhe më tej përpjekjet për miratimin e projektligjeve të parashikuara në Planin Vjetor të Punës së Kuvendit për vitin 2016.</p> |
|--|--|---|--|

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | janë miratuar në bazë të procedurës së përshpejtuar. Kjo gjë ka kufizuar mundësinë për debat parlamentar, çështje që është mjaft shqetësuese; | Administrata e Kuvendit ka nevojë për të forcuar kapacitetet e saj teknike për të mbështetur politikë-bërjen efektive dhe për të përmirësuar shqyrtimin e draft legjislacionit; 1.4 (i) Kuvendi i Kosovës duhet të rrisë debatin parlamentar dhe gjithashtu kontrollet parlamentare mbi nevojat e kontrollit buxhetore duhen përmirësuar; |
|--|--|---|---|

II. Parandalimi dhe Luftimi i Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit

| Fusha | Veprimet që duhet të ndërmerren (Treguesit) | Çfarë është bërë deri më tani? | Çfarë duhet bërë më tutje/Rekomandimet |
|---|---|---|--|
| 2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë; | 2.1. Miratimi i legjislacionit për parandalimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë pastrimin e parave, krimin ekonomik dhe financiar, konfiskimin dhe kthimin e asetëve; | 2.1 (a) Ligji për ndryshimin e Ligjit për Gjykatat, ndryshimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe ndryshimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 28 maj 2015. Në anën tjetër, Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) ende nuk është ndryshuar. Së fundi, Ligji për Kundërvajtje, mbetet të miratohet, i cili është i rëndësishëm sepse do të shkarkojë vëllimin e rasteve gjyqësore duke instaluar mekanizmat e shqyrtimit brenda | 2.1 (a) Duhet që të ndryshohet legjislacioni, dhe të parashikohet krijimi i një policie gjyqësore për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), në mënyrë që të përmirësohet ndjekja penale e rasteve të profilit të lartë; 2.1 (a) Duhet të miratohet Ligji për Kundërvajtje, i cili është i rëndësishëm sepse do të shkarkojë vëllimin e rasteve gjyqësore, duke instaluar mekanizmat e |

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | <p>institucioneve që inicojnë procedurat kundërvajtëse në gjykatë;</p> <p>2.1 (b) Kuadri ligjor për luftën kundër korrupsionit është konsoliduar me ndryshimin e tre ligjeve, Ligji për Financimin e Partive Politike; Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë; dhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike. Këto ligje janë në përputhje me dispozitat e Kodit Penal, duke siguruar që veprat penale të lidhura me korrupsionin janë kriminalizuar. Për të plotësuar kuadrin ligjor në fushën e konfiskimit të pasurisë, më 14 janar 2014 Kryeprokurori i Shtetit miratoi Udhëzimin Administrativ për zbatimin e dispozitave ligjore në lidhje me ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve;</p> <p>2.1 (c) Në shkurt, Kuvendi miratoi një strategji të re dhe plan të veprimit kundër korrupsionit (2013-2017); Zbatimi i strategjisë kundër korrupsionit nuk po arrin të gjenerojë rezultate efektive, për shkak të mbështetjes së dobët politike;</p> <p>2.1 (d) Kuadri i politikave gjithashtu është konsoliduar më tej përmes miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) të Planit të Veprimit për Luftimin e Korrupsionit, më 4 nëntor 2013. Ai adreson gjetjet e</p> | <p>shqyrtimit brenda institucioneve që inicojnë procedurat kundërvajtëse në gjykatë;</p> <p>2.1 (b) Kuadri ligjor në fushën e konfiskimit të asetëve parasheh konfiskimin vetëm pas vendimit gjyqësor përfundimtar. Prandaj, procedimi i konfiskimit <i>in rem</i> apo ligji anti-mafia (iniciuar tashmë nga organi i mëparshëm legjislativ) duhet të konsiderohet si opsion;</p> <p>2.1 (c) Strategjia dhe plani i veprimit kundër korrupsionit (2013-2017) duhet të zbatohet. Funkzioni mbikëqyrës i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) lidhur me zbatimin e strategjisë duhet të forcohet, duke përfshirë ndarjen e buxhetit të përshtatshëm për secilin institucion për të zbatuar strategjinë dhe planin e veprimit;</p> <p>2.1 (d) Planin e Veprimit i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) në luftën kundër korrupsionit duhet të zbatohet. Duhet të rritet matja e performancës për prokurorët, në mënyrë që të forcohet lufta kundër krimeve të rënda;</p> |
|--|--|---|---|

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>analizës gjithëpërfshirëse dhe vlerësimi të rasteve aktuale në të gjitha zyrat e Prokurorisë Themelore dhe të Prokurorisë Speciale (PSRK). Ai gjithashtu i obligon të gjithë prokurorët për të trajtuar të gjitha rastet e korrupsionit e marra deri në mes të vitit 2014, dhe parashikon masa disiplinore ndaj të gjithë prokurorëve dhe stafit mbështetës në rastet e neglizhencës subjektive ose dështimin për të ushtruar detyrimet e tyre prokuroriale që rrjedhin prej tij.</p> <p>Në nivel lokal (rajoni i Pejës dhe Gjakovës), rastet e korrupsionit janë zgjidhur në përputhje me këtë plan të veprimit;</p> <p>Në vitin 2014, nga totali i rasteve të zgjidhura që përfshinin 1011 persona, prokuroritë kanë deponuar padi kundër 471 personave ose 47%, dhe kanë mbyllur raportet penale si dhe ndërprerë hetimet kundër 545 personave ose 54%;</p> <p>2.1 (e) Për sa i përket akteve nënligjore, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ka miratuar një rregullore nr. 01/2014 për Rregullat e Punës së AKK-së. Kjo rregullore plotëson dispozitat e ligjeve në lidhje me mandatin e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe deklarimin e pasurive nga ana e zyrtarëve të lartë;</p> <p>2.1 (f) Reformat kryesore të Kodit të ri të Procedurës Penale kanë të bëjnë me eliminimin e mundësisë së korrupsionit duke përmirësuar kontrollin dhe balancin e palëve të përfshira në procedurën penale;</p> | |
|--|--|--|--|

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>Përmirësimi i procesit të hetimit të krimeve të ndërlikuara (duke përfshirë përkufizimin e saktë të masave të hetimit të fshehtë, përgjimeve, simulimeve dhe marrjen e të dhënave financiare në fazat e hershme të procedurës penale); përmirësimi i efikasitetit të procedurës (duke përfshirë eliminimin e procedurës së konfirmimit të aktakuzës); rregullimin dhe përkufizimin e saktë të kompetencës dhe bashkëpunimit të policisë me prokurorët; Përkufizimin e një faze të hetimit formal me më shumë të drejta për të pandehurit; përmirësimin e rregullave për të marrë dëshmitë në procedurën para gjyqit; sqarimin e rregullave për marrjen e ekspertizës nga ekspertët e jashtëm të të gjitha fushave. Këto reforma kanë krijuar kushte për dëshmi më të mirë e më të qëndrueshëm në procedurë, si dhe vendosjen e rregullave më të kujdesshme për mbrojtjen e të pandehurve në paraburgim;</p> <p>2.1 (g) Kosova deri më tani ka bërë përparim të konsiderueshëm në forcimin e kuadrit ligjor dhe strategjik në luftën kundër krimit të organizuar. Paketa e gjashtë ligjeve kryesore që kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2013 (Ligjet për gjykatat, Prokurorinë e Shtetit, Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, si dhe Kodin Penal dhe të Procedurës Penale) sollën ndryshime të rëndësishme dhe reformat më të thella në sistemin e drejtësisë në Kosovë, gjithashtu edhe duke kompletuar infrastrukturën ligjore në fushën e drejtësisë penale dhe shmangien e zbrastësirave ligjore dhe mangësitë.</p> <p>Në janar të vitit 2014, kuadri strategjik në luftën kundër krimit të</p> | |
|--|--|---|--|

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>organizuar është forcuar më tej përmes miratimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekonomisë Joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar;</p> <p>2.1 (h) Plani i veprimit për strategjinë për parandalimin e pastrimit të parave është i përfshirë në dokumentin e strategjisë kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018, të miratuar në janar të vitit 2014.</p> <p>2.1 (i) Janë miratuar disa akte nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, si: Udhëzimi Administrativ për ndryshimin e identitetit të personit të mbrojtur, dhe Udhëzimi administrativ për menaxhimin e fond të veçantë për mbrojtjen e dëshmitarëve, të dyja të nënshkruara më 27 shtator 2012;</p> <p>2.1 (j) Marrëveshja Ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë së bashku me Ligjin për ndryshimin e ligjeve që lidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës, në prill të vitit 2014. Mandati i ri i EULEX-it parasheh që të të gjitha rastet e reja do të udhëhiqen nga zyrtarët e Kosovës, që do të thotë se EULEX-i tani do të merrej vetëm me rastet e pranuar para 15 korrikut të vitit 2014, dhe me kërkesë të vendasve;</p> | |
|--|--|--|--|

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | | |
| <p>2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë;</p> | <p>2. 2. Të sigurohet që ndryshimet në këtë legjislacion janë në përputhje me <i>acquis</i> të BE-së dhe janë të pasqyruara në kodin penal;</p> | <p>2.2 (a) Kosova ka plotësuar kuadrin e nevojshëm të politikave në fushën e luftës kundër korrupsionit. Këto politika janë në përputhje me standardet e BE-së dhe <i>acquis</i>-të përkatëse;</p> <p>2.2 (b) Ministria e Integritimit Europian (MIE) ka hartuar Rregulloren për procesin e përkthimit të <i>acquis</i> së BE-së në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Nëpërmjet kësaj rregulloreje, MIE parashikon të harmonizojë procesin e përkthimit të <i>acquis</i>, duke unifikuar të gjitha procedurat, format, si dhe terminologjinë e legjislacionit. Kjo rregullore pritet të hyjë në fuqi sapo procedurat administrative të jenë finalizuar. Për më tepër, grupi i tetëmbëdhjetë pjesëmarrësve nga institucione të ndryshme të nivelit qendror që kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në Trajnimin e Trajnerëve (TeT) mbi Harmonizimin Ligjor dhe përdorimin e Tabelave të Pajftueshmërisë janë certifikuar më 14 maj 2014. Në qershor të vitit 2014, seanca e parë e trajnimit për zyrtarët e institucioneve publike përkatëse ka filluar zyrtarisht;</p> <p>2.2 (c) Kosova ka plotësuar kuadrin e nevojshëm të politikave në fushën e luftës kundër korrupsionit. Këto politika janë në përputhje me standardet e BE-së dhe <i>acquis</i>- të përkatëse;</p> <p>2.2 (d) Kuadri ligjor kundër korrupsionit që është konsoliduar</p> | <p>2.2 (a) Njohja me tabelat e pajftueshmërisë me <i>acquis</i> dhe koncept letrat, paraqet një hap përpara. Ato duhet të përdoren në mënyrë sistematike, duke përfshirë pasqyrat financiare;</p> <p>2.2 (b) Duhet të shqyrtohen më të mirë projektligjet dhe ndryshimet në legjislacion, në mënyrë që të sigurohet harmonizimi i procesit të përkthimit të <i>acquis</i>, duke unifikuar të gjitha procedurat, format, si dhe terminologjinë e legjislacionit. Ministria e Integritimit Europian duhet të finalizojë sa më shpejt që të jetë e mundur të gjitha procedurat administrative në mënyrë që Rregullorja për procesin e përkthimit të <i>acquis</i> së BE-së të hyjë në fuqi;</p> <p>2.2 (c) Qeveria duhet të sigurohet që të gjithë personat përgjegjës publik të cilët punojnë në harmonizimin dhe miratimin e <i>acquis</i> së BE-së, duhet të marrin pjesë në trajnime mbi këtë temë, për të siguruar një adoptim më të mirë dhe më efikas të <i>acquis</i>;</p> |

| | | | |
|---|---|--|---|
| | | me ndryshimin e tri ligjeve: Ligji për financimin e partive politike; Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë; dhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike, janë në përputhje me dispozitat e Kodit Penal, duke siguruar që veprat penale të lidhura me korrupsionin të penalizohen; | |
| 2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë; | 2.3. Zbatimi i legjislationit të lartpërmendur mbi parandalimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë pastrimin e parave, krimin ekonomik dhe financiar, konfiskimin dhe kthimin e aseteve; | <p>2.3 (a) Lidhur me kapacitetet institucionale të prokurorive për të luftuar korrupsionin, më 18 nëntor 2013, Kryeprokurori i Shtetit emëroi një prej prokurorëve të zyrës së tij si koordinator kombëtar përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zyrave të prokurorisë për zbatimin e Planit të Veprimit të përmendur më sipër. Për më tepër, numri i prokurorëve të ngarkuar me trajtimin e rasteve të korrupsionit është rritur nga 13 në 40 prokurorë. Megjithatë, Kosova ende duhet të forcojë kapacitetet dhe strukturën e saj, që të ketë prokurorë të specializuar shtetëror për të luftuar korrupsionin;</p> <p>2.3 (b) Më 20 janar 2014, Kryeprokurori i Shtetit ka krijuar Komisionin e verifikimit dhe të mbikëqyrjes i mandatuar për të mbledhur të dhënat në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit. Më 25 shkurt 2014, Këshilli Prokuroria i Kosovës (KPK) miratoi raportin e Komisionit, së bashku me gjetjet dhe rekomandimet;</p> <p>2.3 (c) Në nëntor, Këshilli Prokurorial i Kosovës miratoi një plan strategjik për bashkëpunimin</p> | <p>2.3 (a) Ndërsa ka përmirësime të dukshme në ngritjen e akuzave penale në nivelin e përgjithshëm të prokurorisë, rastet që kanë të bëjnë kryesisht me rastet e vogla të krimit të korrupsionit, vazhdojnë që ta zhvendosin vëmendjen nga nevoja që Kosova të hetojë, të padisë dhe dënojë rastet e korrupsionit të profilit të lartë;</p> <p>2.3 (b) Shërbimet prokuroriale duhet të përpiqen për të forcuar legjislationin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK). Shërbimet e prokurorisë mund të përdorin shembullin e ligjit të Kroacisë mbi USKOK-në, duke ndryshuar Ligjin e PSRK-së për të përfshirë një mandat të qartë për prokurorët special të</p> |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>ndër-institucional për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar;</p> <p>2.3 (d) Në lidhje me strukturën e gjykatave, pas rezultateve të vitit 2013, në luftën kundër korrupsionit dhe vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) të vitit 2012 për të ju dhënë përparësi rasteve të korrupsionit, KGJK-ja miratoi një vendim shtesë për themelimin e Komisionit për të mbikëqyrur punën e gjyqtarëve në rastet e korrupsionit;</p> <p>2.3 (e) Për të plotësuar kuadrin ligjor në fushën e konfiskimit të pasurisë, më 14 janar 2014, Kryeprokurori i Shtetit miratoi Udhëzimin Administrativ për zbatimin e dispozitave ligjore në lidhje me ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve. Megjithatë, efektiviteti i sistemit do të mund të përmirësohet më tej. Buxheti dhe stafi i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar (AAPSK) është rritur në krahasim me vitet e mëparshme; Megjithatë, kapacitetet e plota të infrastrukturës së AAPSK mbeten sfidë pasi që konfiskimet fillojnë vetëm pas vendimit të gjykatës;</p> <p>2.3 (f) Për të garantuar zbatimin e marrëveshjes dhe mandatin e ri të EULEX-it, Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është ndryshuar. Gjithashtu, është miratuar një grup i akteve ligjore të legjislacionit dytësor dhe janë arritur disa marrëveshje ndër-institucionale;</p> <p>2.3 (g) Në mënyrë që të vazhdohet</p> | <p>Kosovës, të hartuar në një kuadër të veçantë ligjor, duke përfshirë strukturën dhe përbërjen e PSRK-së me një menaxhim dhe strukturë të qartë organizative. Qeveria e Kosovës duhet të dyfishojë fondet për PSRK-në deri në 1,120,000.00 € (nga shuma e tanishme prej 593,000.00 €), me qëllim forcimin e kapaciteteve prokuroriale që duhet të luftojnër rastet e korrupsionit të profilit të lartë;</p> <p>2.3 (c) Performanca e prokurorëve duhet të matet rregullisht; Duhet rritur matjen e performancës për prokurorët, në mënyrë që të forcohet lufta kundër krimeve të rënda;</p> <p>2.3 (d) Duhet të zbatohet plani strategjik i Këshillit Prokurorial të Kosovës për bashkëpunim ndër-institucional në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, duke organizuar gjithashtu takime të nivelit të lartë për të monitoruar zbatimin e planit strategjik;</p> <p>2.3 (e) Performanca e gjyqtarëve duhet të matet në rregullisht, si dhe duhet të ketë pasoja</p> |
|--|--|--|--|

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | <p>me zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, në qershor të vitit 2014, u nënshkrua një Procedurë Standarde Operative (PSO) për përfundimin e programit të paraparë me ligj për mbrojtjen e dëshmitarëve. Me qëllim të rritjes së kapaciteteve në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar 8 trajnime për 33 pjesëmarrësit që merren me mbrojtjen e dëshmitarëve. Zyrtarët e mbrojtjes së dëshmitarëve gjithashtu kanë marrë pjesë në një trajnim të avancuar për bashkëpunim ndërkombëtar të organizuar në Holandë, i cili gjithashtu rezultoi në dhënien e anëtarësimit për Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve (DMD) nga EUROPOL, për të hyrë në platformën e tij të ekspertizës për mbrojtjen e dëshmitarëve;</p> <p>2.3 (h) Një rrjet i prokurorëve që merren me rastet e korrupsionit vazhdojnë të punojnë në rastet e korrupsionit nën mbikëqyrjen e koordinatorit kombëtar për zbatimin e planit me qëllim rritjen e efikasitetit të sistemit të prokurorisë në luftën kundër korrupsionit. Koordinatori Kombëtar kundër korrupsionit informon publikun, në baza mujore, me të arriturat në zbatimin e Planit të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit të Sistemit të Prokurorisë në Luftën Kundër Korrupsionit . Që nga 1 maji deri me 31 korrik të vitit 2014, Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka siguruar trajnime për gjyqtarët dhe prokurorët në luftën kundër korrupsionit;</p> | <p>disiplinore për gjyqtarët që dështojnë për të përmbushur nivelin e kërkuar të performancës;</p> <p>2.3 (f) Qeveria e re e Kosovës duhet të marrë në konsideratë rritjen e mëtejshme të buxhetit të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar (AAPSK), në mënyrë që ky organ të jetë në gjendje për të përmbushur si duhet mandatin e vet. Gjithashtu trajnime për të rritur ekspertizën e stafit duhet të merren parasysh;</p> <p>2.3 (g) Kosova duhet të marrë parasysh zhvendosjen ndërkombëtare të dëshmitarëve në rastet e ndjeshme;</p> |
| <p>2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të</p> | <p>2. 4. Miratimi i legjislacionit për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të</p> | <p>2.4 (a) Në korrik të vitit 2013, është miratuar Ligji për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve</p> | |

| | | | |
|---|---|---|--|
| <p>organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë;</p> | <p>trafikimit të qenieve njerëzore;</p> | <p>Njerëzore dhe Mbrojtjen e Viktimave. Koordinatori Kombëtar Kundër Trafikimit bashkëpunon me autoritetet përkatëse dhe shoqërinë civile. Gjithashtu, Kodi Penal i Kosovës ka një kapitull të veçantë në luftimin e trafikimit;</p> <p>2.4 (b) Në maj të vitit 2015, strategjia e re për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Planit të Veprimit 2014-2019 është miratuar nga qeveria;</p> <p>2.4 (c) Është hartuar dhe miratuar në maj të vitit 2015, Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit;</p> | <p>2.4 (b) Para zbatimit të Strategjisë së re kundër Trafikimit, është i nevojshëm një vlerësim i detajuar i zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit të kaluar kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2011-14), në mënyrë që strategjia e re të ketë sukses;</p> <p>2.4 (c) Të zbatohet Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, pasi që institucionet e Kosovës kanë mohuar deri tani kompensimin për viktimat e krimeve, duke përfshirë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore;</p> <p>2.4 (d) Të sigurohet një financim i qëndrueshëm për programin e kompenzimit të viktimave të krimit, të paraparë në ligjin për Kompenzimin e Viktimave të Krimit;</p> <p>2.4 (d) Të sigurohet mbështetje dhe ndihmë e duhur për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, ashtu që të identifikohen si duhet viktimat e trafikimit, t'u ofrohet mbrojtje më afatgjatë dhe të bëhet riintegrimi i viktimave në shoqëri, në mënyrë për të nxjerrë dënimet e duhura për trafikantët, duke</p> |
|---|---|---|--|

| | | | |
|---|---|--|---|
| | | | përfshirë dënimin e zyrtarëve të përfshirë në trafikim (në përputhje me Raportin e Departamentit të Shtetit Amerikan mbi Trafikimin e Personave, 2013) |
| 2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë; | 2. 5. Zbatimi i legjislacionit kundër trafikimit në hetimet dhe ndjekjet penale proaktive të trafikimit të qenieve njerëzore duke përfshirë edhe zhvillimin e një mekanizmi përcjellës, për dënimin adekuat në pajtim me ligjin në fuqi; | <p>2.5 (b) Me qëllim të plotësimit të kuadrit ligjor, si dhe implementimin dhe zbatimin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, Udhëzimi Administrativ për licencimin e OJQ-ve u miratua në Dhjetor 2013, që rregullon licencimin e OJQ-ve për strehimin e viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe viktimat e dhunës në familje.</p> <p>Edhe pse, Kosova kishte Ligjin për Familjen dhe Shërbimet sociale që nga viti 2005, i cili ka parashikuar rolin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të licencojë OJQ-të që ofrojnë shërbime për viktimat, megjithatë, legjislacioni nuk është zbatuar.</p> <p>Gjithashtu, korniza legjislative lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, armëve dhe drogës ka përfunduar;</p> <p>2.5 (c) Institucionet e Kosovës kanë bërë progres të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të kushteve për rehabilitimin e viktimave të trafikimit. Në këtë drejtim, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) menaxhon një Strehimore Speciale të Përkohshme, me qendër në Lipjan e cila ofron strehim dhe rehabilitim për të gjitha viktimat. Për më tepër, gjatë vitit 2014, Policia e Kosovës (PK) ka identifikuar 42 viktima të trafikimit ndërsa, gjatë tremujorit të parë të</p> | <p>2.5 (b) Kosova duhet të fokusohet në zbatimin e Ligjit për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, veçanërisht në lidhje me kompensimin e viktimave dhe financimin e qëndrueshëm të strehimoreve. Një qasje gjithëpërfshirëse, multi-disiplinore dhe e orientuar nga viktimat e trafikimit duhet të zhvillohet, si dhe identifikimi i viktimave ka nevojë të përmirësohet më tej;</p> <p>2.5 (c) Sipas nevojës, duhet të kryhen trajnime të tjera; Palët e tjera të interesuara të tilla si: policia kufitare, inspektorët dhe prokurorët e punës duhet të jenë të trajnuar në procedurat standarde ekzistuese operative, si dhe gjithashtu të rrisin kapacitetet e tyre për të identifikuar dhe për të ndihmuar fëmijët lëmshëtarë që janë viktima të trafikimit;</p> |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>vitit 2015, 7 viktime. Viktimat më pas janë dërguar në strehimoret përkatëse;</p> <p>2.5 (d) Në lidhje me statistikat për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, 66 raste kanë qenë nën hetime gjatë vitit 2014, me gjithsej 181 persona. Prokurorët në vitin 2014 kanë zgjidhur kallëzimet penale për 56 persona për veprat penale të grupit të Trafikimit me njerëz, nga të cilat për 18 persona është hudhur kallëzimi penal dhe hetimi është ndërprerë, ndërsa 38 persona janë paditur. Lidhur me këto aktakuza, gjykatat kanë marrë vendime për 25 persona, nga të cilët 24 persona janë shpallur fajtor dhe 1 person është shpallur i pafajshëm. Procedura kundër 13 personave të tjerë është në zhvillim e sipër;</p> <p>2.5 (e) Sa i përket ndërtimit të kapaciteteve një seancë trajnimi në temën e trafikimit të fëmijëve është mbajtur për policinë. Gjithashtu, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ju ka dhënë informacion për fëmijëve, mësuesve dhe prindërve në 98 shkolla në 11 komuna në lidhje me Trafikimin e Qenieve Njerëzore. Përveç kësaj, Rregullorja mbi Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar 21/2013, u është shpërndarë të gjitha shkollave të të gjitha niveleve në tërë Kosovën. Gjithashtu, koordinatori kundër trafikimit ka nisur një fushatë për rritjen e vetëdijës së publikut ('hapini sytë') dhe një seri të ngjarjeve informative;</p> <p>2.5 (f) Gjatë vitit 2014, Policia e Kosovës ka shpërbërë shtatë (7)</p> | <p>2.5 (d) Duhet të zhvillohet një mekanizëm efektiv për të përcjellur rastet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për të siguruar që dispozitat e reja për mbrojtjen, të përcaktuara në ligjin e shtatorit të vitit 2013, janë zbatuar plotësisht;</p> <p>2.5 (e) Ministria e Arsimit duhet të zhvillojë një kurrikulë trajnimi për mësuesit dhe shkollat për rritjen e ndërgjegjësimit mbi trafikimin me qenie njerëzore në Kosovë. Këto trajnime duhet të ofrohen në tërë Kosovën;</p> |
|--|--|--|--|

| | | | |
|---|--|--|---|
| | | grupe kriminale qe kane qenë të organizuara në nivel te mbrendshëm. | |
| 2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë; | 2. 6. Zbatimi i strategjive dhe planeve të veprimit në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit të qenieve njerëzore; | <p>2.6 (a) Sipas një vlerësimi të kryer në pjesën e dytë të vitit 2013, 64% e aktiviteteve të parapara në strategjitë kundër krimit të organizuar kanë filluar të zbatohen gjatë vitit 2012, ndërkohë që 36% e aktiviteteve kanë filluar të zbatohen në vitin 2013;</p> <p>2.6 (b) Në kapacitetet institucionale të prokurorive për të luftuar korrupsionin, më 18 nëntor 2013, Kryeprokurori i Shtetit emëroi një prej prokurorëve të zyrës së tij si koordinator kombëtar përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zyrave të prokurorisë për zbatimin e Planit të Veprimit të përmendur më sipër. Për më tepër, numri i prokurorëve të ngarkuar me trajtimin e rasteve të korrupsionit është rritur nga 13 në 40 prokurorë. Në lidhje me rastet e pranuar në përgjithësi nga prokuroritë dhe të hapura për hetim të mëtejshëm ose aktakuza, shërbimet prokuroriale të Kosovës përfshirë zyrën e PSRK-së, vitin 2014, kanë trajtuar 976 raste të korrupsionit, ndërsa vetëm 45 %, ose 444 raste kanë hapur. Më shumë se gjysma e rasteve kanë mbetur të pazgjidhura 55%, ose 532 raste;</p> <p>2.6 (c) Më 20 janar 2014, Kryeprokurori i Shtetit ka krijuar Komisionin e verifikimit dhe të mbikëqyrjes, i cili është i mandatuar për të mbledhur të dhënat në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit. Më 25 shkurt 2014, pas rekomandimeve të Komisionit, KPK-ja lëshoi një vendim që kërkoi nga të gjitha Zyrat e Prokurorive Themelore dhe</p> | <p>2.6 (a) Zbatimi i strategjive dhe planeve të veprimit kërkon më shumë zotim nga të gjithë akterët e përfshirë, mbështetjen e vazhdueshme në nivelin më të lartë politik dhe përkushtim nga të gjithë të përfshirët;</p> <p>2.6 (c) Duhet të matet rregullisht performance e punës së prokurorëve, veçanërisht të prokurorëve special; Me një normë mesatare të performancës 26% nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) në dënime, nuk mbeten gjasa që misioni I PSRK-së do të zbatohet me sukses. Prandaj, për të forcuar performancën e punës së PSRK-së, duhet të konsiderohet mundësia për të ndryshuar ligjin për PSRK-në, në mënyrë që të parashikohet një rritje e numrit të prokurorëve, burimeve dhe buxhetit për PSRK-në, si dhe një njësi e zyrtarëve të policisë në kuadër të strukturës së rekrutimit dhe menaxhimit të PSRK-së;</p> <p>2.6 (d) Duhet të kryhet</p> |

| | | | |
|-----------------------|-------------------------|---|--|
| | | <p>Prokurorisë Speciale (PSRK) të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, kundër të gjithë prokurorëve përgjegjës që nuk kanë plotësuar detyrimet e tyre që rrjedhin nga plani i veprimit;</p> <p>2.6 (d) Në lidhje me strukturën e gjykatave, pas rezultateve të vitit 2013, në luftën kundër korrupsionit dhe vendimin e Këshillit Gjyqësor (KGJK) të vitit 2012 për t'u dhënë përparësi rasteve të korrupsionit, KGJK-ja miratoi një vendim shtesë në themelimin e Komisionit për të mbikëqyrur punën e gjyqtarëve në rastet e korrupsionit;</p> <p>2.6 (e) Sa i përket zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit kundër korrupsionit, një numër i konsiderueshëm i komunave kanë mekanizma për identifikimin e rasteve të korrupsionit. Prandaj, ka komuna që kanë një zyrtar, i cili mban kontakte në mes të Komunës dhe Agjencisë kundër Korrupsionit;</p> <p>2.6 (f) Me qëllim të implementimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, në dhjetor të vitit 2013, u miratua Udhëzimi Administrativ për licencimin e OJQ-ve, që rregullon licencimin e OJQ-ve për strehimin e viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe viktimat e dhunës në familje. Është e rëndësishme të theksohet se korniza legjislative lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, armëve dhe drogës ka përfunduar dhe është përgjithësisht në përputhje me standardet e BE-së;</p> | <p>rregullisht matja e performancës së punës së gjyqtarëve. Duhet rritur matjen e performancës së gjyqësorit në mënyrë që të forcohet lufta kundër krimeve të rënda;</p> <p>2.6 (f) Duhet të rritet bashkëpunimi me shoqërinë civile, si dhe përpjekjet për të përmirësuar efektin e masave parandaluese;</p> |
| 2) Parandalimi | 2.7. Rishikimi i | 2.7 (a) Kuadri ligjor për luftën | |

| | | | |
|---|--|---|---|
| <p>dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë;</p> | <p>dokumente nëse është e nevojshme, me veprim efektiv; dhe vendosja e treguesve të qartë për të matur performancën në këto fusha;</p> | <p>kundër korrupsionit është konsoliduar me ndryshimin e tre ligjeve, Ligji për Financimin e Partive Politike; Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë; dhe Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike. Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtarë është në përputhje me Kodin Penal, në mënyrë që tani dështimi për të deklaruar pasurinë, si dhe deklaratat e rreme janë klasifikuar si vepra penale;</p> <p>2.7 (b) Në mars të vitit 2013, u miratua Ligji i ri për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Ligji parashikon konfiskimin e pasurisë që nuk rrjedh drejtpërdrejt nga një aktivitet kriminal, për të cilin personi është dënuar. Gjithashtu, ligji prezanton parimin e barrës së kundërt të provës. Megjithatë, këto dispozita të reja ligjore lejojnë konfiskimin e aseteve të lidhur me pasurinë e pashpjegueshme, vetëm në rastet pasi vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë ;</p> <p>2.7 (c) Në lidhje me sekuestrimin dhe ngrirjen e aseteve nga krimet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke përfshirë rastet e drogës dhe trafikimit të qenieve njerëzore, sipas Agjencisë së Kosovës për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AMPSK) shuma e përgjithshme e aseteve të</p> | <p>2.7 (f) Buxheti për gjyqësorin duhet të rritet më tej. Qeveria ka vazhduar të ofrojë më pak se 3% të buxhetit vjetor të Kosovës në financimin e gjykatave dhe Prokurorinë</p> |
|---|--|---|---|

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>sekuestruar përkohësisht në 2013 ishte rreth 1.5 milion Euro. Megjithatë, këto raste janë në pritje të vendimeve përfundimtare të gjykatave dhe nuk mund të konfiskohen në mënyrë të përhershme dhe të transferohen në buxhetin e Kosovës. Vlera e të ardhurave nga krimet e korrupsionit, krimet të organizuar duke përfshirë trafikimin e drogës dhe qenieve njerëzore të konfiskuara ishte vetëm 6,700 mijë euro në vitin 2013. Sipas Koordinatorit Kombëtar për Krime Ekonomike, në vitin 2014 shuma e mjeteve të sekuestruara ka qenë 31 milionë Euro, ndërsa pas 15 vendimeve të gjykatave janë konfiskuar mjete në vlerë 25.000 mijë Euro. Këto shifra të ulëta në sasinë ekonfiskuar tregojnë ngurrimin e institucioneve të Kosovës për të ecur përpara me kërkesat e BE-së në lidhje me dënimet penale të kryera dhe konfiskimin e aseteve kriminale. Sa i përket shifrave për periudhën Janar-Qershor 2015, shuma e sekuestruar është 16,123,010.00 Euro, kurse shuma e konfiskuar është 64,487.65 Euro.</p> <p>2.7 (d) Strategjia e re dhe Plani i Veprimit 2014-2019 për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore është përfunduar nga grupi punues dhe është miratuar nga Qeveria në maj të vitit 2015;</p> <p>2.7 (e) Lidhur me bashkëpunimin me EULEX-in, letrat e shkëmbyera mes Presidentes së Kosovës dhe të Përfaqësueses së Lartë të BE-së, më 23 prill 2014 janë ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, si një marrëveshje ndërkombëtare përmes Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës</p> | <p>e Shtetit;</p> <p>2.7. (g) Duhet të rritet numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve në nivel lokal, në mënyrë që gjykatat dhe prokuroritë të mund të merren, në mënyrë efektive, me ngarkesën e punës;</p> |
|--|--|--|--|

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | <p>dhe Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Për më tepër, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë me 23 prill 2014;</p> <p>2.7 (f) Buxheti i ndarë për gjykata dhe prokurori ka qenë vazhdimisht në rritje gjatë viteve. Ka pasur edhe një rritje të vazhdueshme të gjyqtarëve (nga 258 në 322) dhe prokurorëve (nga 146 në vitin 2012 dhe 2013 në 171 në vitin 2014) si dhe të stafit mbështetës të gjykatave dhe prokurorive. Megjithatë, numri mbetet i pamjaftueshëm. Rritja e numrit të gjyqtarëve mbetet një sfidë në nivel lokal (rajoni i Pejës dhe Gjakovës).</p> <p>2.7 (g) Për të garantuar zbatimin e marrëveshjes dhe mandatin e ri të EULEX-it, Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është ndryshuar. Gjithashtu, është miratuar një grup i akteve ligjore të legjislacionit dytësor dhe janë arritur disa marrëveshje ndërinstitucionale;</p> | |
| <p>2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë;</p> | <p>2.8. Zhvillimi i hetimeve proaktive për pasurinë e pashpjegueshme; si dhe zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi solid të konfiskimit dhe menaxhimit të pasurive;</p> | <p>2.8 (a) Në mars të vitit 2013, u miratua Ligji i ri për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë. Ligji i ri lejon konfiskimin e pasurisë të lidhur me pasurinë e pashpjegueshme. Megjithatë, vetëm pasi vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë;</p> <p>2.8 (b) Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të</p> | <p>2.8 (a) Origjina e pasurisë duhet të deklarohet dhe të verifikohet nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), në pajtim me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë dhe kërkesat e reja të Kodit Penal, duke zbatuar plotësisht legjislacionin dhe duke i dhënë fund mosndëshkimit përmes verifikimit të plotë të pasurisë së të gjithë zyrtarëve të lartë dhe</p> |

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | <p>gjithë personat zyrtarë është në përputhje me Kodin Penal; Agjencia ka kapacitet për të verifikuar origjinën dhe vërtetësinë e pasurisë së deklaruar vetëm për 20% të rasteve, në përputhje me kërkesat e ligjit të ri;</p> <p>Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) e konsideron si ndryshim pozitiv faktin e rritjes së seriozitetit të dënimeve për veprat penale në lidhje me mos-zbulimin ose deklarimin e rremë të pasurisë si dhe atyre që lidhen me konfliktin e interesit. Duke pasur parasysh se këto vepra penale janë dënuar jo si kundërvatje, por si vepra penale, AKK ka vënë re se ka një rënie të konsiderueshme të këtyre veprave;</p> <p>2.8 (c) Vlera totale e aseteve të sekuestruara nga Policia e Kosovës gjatë periudhës janar - mars 2014 ka arritur deri në 110,207.10 euro. Krahasuar me vitet e mëparshme, numri i rasteve që përfshijnë konfiskimin e aseteve dhe sekuestrimin (menaxhuar nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo Konfiskuar (AAPSK)) është rritur; Megjithatë, Kosova ende përballet me sfida në lidhje me konfiskimin e pasurisë për shkak të mungesës së vendimeve të formës së prerë në lidhje me rastet e krimeve të rënda. Në përgjithësi, ka pasur ngurrim për të nxjerrë vendime gjyqësore në lidhje me konfiskimin e pasurisë, andaj konfiskime të tilla nuk kanë ndodhur deri më tani në Kosovë. Sa i përket shifrave për periudhën Janar-Qershor 2015, shuma e sekuestruar është 64,487.65 Euro 16.123.010,00 Euro, kurse shuma e konfiskuar është 64,487.65 Euro;</p> <p>2.8 (d) Me ndihmën e SHBA-ve</p> | <p>urdhërimit të shlyerjes së plotë të dëmeve të shkaktuara nga deklarimi i rremë i pasurisë para gjykatave. Kosova duhet ta marrë në konsideratë nevojën për përmirësim të sistemit të saj ligjor duke inkorporuar rregullore të mëtejshme dhe të marrë në konsideratë zhvillimin e sistemit të parandalimit për kapjen dhe konfiskimin e pasurisë së arritur nga veprimet e paligjshme nga personat që i përkasin organizatave të tipit të mafias. Në këto raste, Kosova duhet të marrë në konsideratë përdorimin e pasurive kriminale të konfiskuara dhe t'i kthejë ato për nevojat e interesave shoqërore p.sh. fonde shoqërore;</p> <p>2.8 (b) Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit, Administrata Tatimore dhe Policia duhet të parashikojnë shkëmbimin e të dhënave në një masë të caktuar, në mënyrë që të përmirësohet përpunimi i konfliktit të interesit dhe deklarimeve të pasurisë;</p> |
|--|--|---|---|

| | | | |
|-------------------------------------|---|---|--|
| | | <p>është themeluar një bazë e të dhënave në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar; Në praktikë, kjo do të ndihmojë për të mbajtur regjistrin e numrit të rasteve të aseteve së sekuestruara ose të konfiskuara;</p> <p>2.8 (e) Në janar të vitit 2014, Kryeprokurori i Shtetit ka lëshuar udhëzime në lidhje me veprimet e prokurorëve lidhur me pasurinë e sekuestruar apo të konfiskuar përkohësisht, si dhe me shpjegimet për evidentimin e të mirave materiale të krimit, në mënyrë që të kërkohet konfiskimi. Prokurori i shtetit ka caktuar pika kontakti të konfiskimit, në çdo zyrë të prokurorive themelore. Megjithatë, pasi nuk ka raste të konfiskimit në Kosovë, zbatimi i udhëzimeve të tilla ende mbetet për t'u monitoruar;</p> <p>2.8 (f) Institucioneve të Kosovës ende duket se u mungojnë statistikat e rasteve të ngritura nga ana e prokurorëve për të konfiskuar asetet që rrjedhin nga rastet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe duke përfshirë edhe rastet e drogës dhe trafikimit të qenieve njerëzore.</p> <p>5.8 (i) Vlera e të ardhurave nga krimet e korrupsionit, krimit të organizuar duke përfshirë trafikimin e drogës dhe qenieve njerëzore të konfiskuara ishte vetëm 6,700 mijë euro në vitin 2013. Në vitin 2014 shuma e parave të konfiskuara me vendimet përfundimtare të gjykatës ishte rreth 25.000 mijë Euro;</p> | |
| 2) Parandalimi dhe luftimi i | 2. 9. Krijimi i mekanizmave efektivë për të siguruar | 2.9 (a) Këshilli Gjyqësor (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial (KPK) kanë | |

| | | | |
|--|---|--|---|
| <p>krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë;</p> | <p>transparencën e zyrtarëve të zgjedhur duke verifikuar pasurinë e zyrtarëve publikë dhe rritja e efektivitetit të Agjencisë Kundër Korrupsionit;</p> | <p>përforcuar edhe më tej procesin e rekrutimit, emërimit dhe riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe kriteret përkatëse të performancës dhe të vlerësimit duke plotësuar legjislacionin e nevojshëm plotësues. Si rezultat i kriterëve të rrepta të vlerësimit dhe ri-emërimit, një (1) gjyqtar nuk ishte propozuar nga KGJK-ja tek Presidentja e Kosovës për ri-emërim;</p> <p>2.9 (b) Për sa i përket akteve nënligjore, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ka miratuar një rregullore nr. 01/2014 në Rregulloren e Punës së AKK-së. Kjo rregullore plotëson dispozitat e AKK-së;</p> <p>2.9. (c) Agjencia Kundër Korrupsionit ka vazhduar të bashkërendojë zbatimin e strategjisë, ligjeve për deklarimin e pasurisë nga zyrtarët publikë dhe për parandalimin e konfliktit të interesit. Bashkëpunimi në mes Agjencisë dhe prokurorisë është përmirësuar;</p> <p>2.9 (d) Agjencia, në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe komunitat, ka zhvilluar një "linjë të të nxehtë" për të raportuar korrupsionin, nëpërmjet linjave telefonike komunale dhe faqeve të internetit;</p> | <p>2.9 (c) Agjencia Kundër Korrupsionit duhet seriozisht të konsideroj ndryshimin e metodës së verifikimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik. Ky verifikim që deri më tani është bërë kryesisht me short, do të duhej të bëhej në atë mënyrë që të orientohej në verifikimin e deklaratave me vlerë të lartë të pasurisë së deklaruar dhe dyshimin mbi origjinën e asaj pasurie;</p> <p>2.9 (d) Agjencia duhet të organizojë më shumë fushata ndërgjegjësuëse, që nxisin qytetarët të raportojnë korrupsionin;</p> |
| <p>2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë;</p> | <p>2. 10. Forcimi i kapaciteteve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve për të hetuar, ndjekur penalisht dhe gjykuar, në mënyrë të paanshme dhe efektive, rastet komplekse të krimit të organizuar, korrupsionit, krimit ekonomik dhe</p> | <p>2.10 (a) Kosova ende nuk ka një bazë të dhënash elektronike të lëndëve penale. Një Memorandum Mirëkuptimi është nënshkruar më 5 shtator nga Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Kryetari i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), dhe ambasadori i Norvegjisë për zbatimin e një Sistemi të Avancuar</p> | <p>2.10. (a) Duhet të kryhen trajnime për stafin gjyqësor mbi Teknologjinë e Informacionit (TI), për t'u siguruar që zbatimi i bazës së integruar të të dhënave është bërë në një mënyrë më efektive. Në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i këtij</p> |

| | | | |
|--|---|---|---|
| | <p>financiar, duke përfshirë pastrimin e parave duke krijuar një regjistër të hetimeve dhe aktgjykimeve të formës së prerë në rastet që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin, trafikimin e qenieve njerëzore dhe pastrimin e parave;</p> | <p>të Menaxhimit të Informacionit dhe Lëndëve (SMIL) për gjyqësorin e Kosovës dhe shërbimin prokurorial. Norvegjia do të dhurojë € 6 660 000,00 për një periudhë 4 vjeçare për zbatimin e këtij projekti, i cili është pjesë e Strategjisë së Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2012 - 2017. SMIL synon të përmirësojë efikasitetin, përgjegjësinë dhe transparencën e gjyqësorit të Kosovës dhe Shërbimit Prokurorial;</p> <p>2.10 (b) Në nivelin e bashkëpunimit institucional, që synon harmonizimin e statistikave, mekanizmi përcjellës i integruar për hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit është plotësisht funksional. Mekanizmi përcjellës është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me EULEX-in dhe Zyrën e BE-së në Kosovë. Mekanizmi përcjellës ofron statistika të harmonizuara duke filluar nga viti 2013 e tutje;</p> <p>2.10 (c) Në shkurt të vitit 2015, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka miratuar raportin vjetor për vitin 2014 të mekanizmit përcjellës. Raporti pasqyron statistika të harmonizuara në mes të institucioneve të përfshira në përcjelljen e korrupsionit, krimit të organizuar, kontrabandës me drogë etj.;</p> <p>2.10 (d) Sipas raportit vjetor të mekanizmit përcjellës, prokurorët gjatë vitit 2014 kanë punuar në 976 raste me gjithsej 2569 persona të përfshirë, për veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe me akuza penale të specifikuara. Nga numri i përgjithshëm i këtyre rasteve, në fund të periudhës së</p> | <p>rekomandimi, janë të nevojshme njohuritë themelore rreth TI-së, për palët e përfshira;</p> <p>2.10 (e) Kosova duhet të specializojë prokurorët në fushën e krimeve financiare dhe mashtrimin në prokurim, me qëllim për të luftuar krimin e korrupsionit dhe krimet financiare;</p> |
|--|---|---|---|

| | | | |
|--|---|---|--|
| | | <p>raportimit (Janar 2014-Dhjetor 2014), të dhënat tregojnë se 444 (apo 45%) raste janë zgjidhur me 1011 persona të përfshirë, ndërsa 532(ose 55%) raste kanë mbetur të pazgjidhura me rreth 1558 persona të përfshirë;</p> <p>2.10 (e) Ka një mungesë të ekspertizës në mesin e prokurorëve dhe gjyqtarëve për fusha të specializuara të tilla si: krimi financiar, pastrimi i parave dhe mashtrimet në prokurim;</p> <p>2.10 (f) Sipas raportit vjetor të vitit 2014 të mekanizmit përcjellës, prokurorët me vetë-iniciativë kanë deponuar vetëm 11 kallëzime penale kundër 17 personave, sa i përket rasteve të korrupsionit;</p> | <p>2.10 (f) Prokurorët duhet të rrisin shkallën e parashtrimit me vetë-iniciativë të rasteve të korrupsionit;</p> |
| <p>2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë;</p> | <p>2.11. Përmirësimi i bashkërendimit, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe intelegjencës kriminale në mes të autoriteteve gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit, me qëllim të përmirësimit të historikut të Kosovës në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimit ekonomik dhe financiar;</p> | <p>2.11 (a) Në nëntor, Këshilli Prokurorial i Kosovës miratoi një plan strategjik për bashkëpunimin ndër-institucional për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;</p> <p>2.11 (b) Prokuroria tani ofron përgjigje dhe vlerësime sistematike ndaj Agjencisë Kundër Korrupsionit në ndjekjen e rasteve. Në vitin 2014, numri i kallëzimeve penale të ofruara nga Agjencia Kundër Korrupsionit ka qenë gjithsej 147 kallëzime penale ose 29% nga gjithsej raste kundër 186 personave, shkallë më e vogël në krahasim me Policinë e Kosovës e cila ka paraqitur 198 kallëzime penale ose 39% kundër 449 personave;</p> <p>In year 2014, the number of criminal reports offered by the Anti-Corruption Agency to</p> | <p>2.11 (a) Bashkëpunimi në mes të policisë dhe prokurorisë duhet të përmirësohet për të siguruar një rritje të numrit të ndjekjeve penale pas hetimeve, dhe për të siguruar një qasje pro-aktive për luftimin e krimeve të rënda në përputhje me strategjinë dhe planin e veprimit për policimin e udhëhequr nga intelegjenca;</p> <p>2.11 (b) Numri i takimeve të zyrtarëve të lartë të Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK) dhe Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) duhet të rritet me fokus në çështjet e korrupsionit dhe pasurisë së pajustificueshme;</p> |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>prosecutorial services were in total 147 criminal reports or 29% of the total against 186 persons, a lower rate compared to Kosovo Police which submitted 198 criminal reports or 39% against 449 persons;</p> <p>2.11 (c) Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nënshkruar dy marrëveshje me Misionin e EULEX-it, më 18 korrik dhe 12 gusht 2014, në funksion të zbatimit të ligjit për mandatin e ri të EULEX-it;</p> <p>2.11 (d) Në mënyrë që të rrisin më tej bashkëpunimin ndër-institucional për mbrojtjen e dëshmitarëve, dy marrëveshje janë përfunduar në tremujorin e parë të vitit 2014: një në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), nënshkruar më 6 shkurt 2014, si dhe një mes MPB-së dhe EULEX-it, nënshkruar më 11 mars 2014;</p> <p>2.11 (e) Më 28 gusht 2014, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka miratuar raportin 6 mujor për mekanizmat përcjellës. Raporti pasqyron statistika të harmonizuara në mes të institucioneve të përfshira në mekanizmin përcjellës për veprat si: korrupsioni, trafikimi, krimi i organizuar, kontrabanda e drogës etj.;</p> <p>2.11 (f) Zyrtari ndërlidhës i policisë për Njësinë për Intelgjencë Financiare (NJIF) është në proces të emërimit;</p> <p>2.11 (g) Në tetor të vitit 2009, është lidhur një marrëveshje teknike për Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (PK) dhe të dhënave për Imigacion, ndërmjet</p> | <p>2.11 (c) Bashkëpunimi midis Njësisë për Intelgjencë Financiare (NJIF), prokurorisë, dhe policisë duhet të rritet, për të siguruar një qasje pro-aktive për nisjen e hetimeve për pasurinë e pajustificueshme;</p> <p>2.11(f) Zyrtari ndërlidhës i policisë do të përmirësojë bashkëpunimin në mes të Njësisë për Intelgjencë Financiare (NJIF) dhe Policisë së Kosovës (PK). Zyrtari ndërlidhës i policisë duhet të emërohet në mënyrë që ky bashkëpunim të mund të përmirësohet edhe më tej;</p> |
|--|--|--|--|

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>PK-së dhe EULEX-it. Sipas kësaj marrëveshjeje, PK i ka ofruar informacione konfidenciale operative si dhe informacione mbi imigracionin, komponentes së EULEX-it. Më 16 korrik 2013 është nënshkruar Marrëveshja Teknike për shkëmbim të Informatave penale ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe EULEX-it, meqë rast deri tani janë shkëmbyer me dhjetra informacione kriminale ndërmjet PK-së dhe EULEX-it. Gjithashtu, siç kanë raportuar zyrtarët e EULEX-it gjatë një interviste me KIPRED, ndarja e informacioneve bëhet në ekipe të përziera dhe në përputhje me Protokollin e Informacionit. Për më tepër, shkëmbimi i të dhënave është bërë edhe në forumet e organizuara nga institucionet e Kosovës, ku EULEX-i dhe organizatat ndërkombëtare janë ftuar të marrin pjesë;</p> <p>2.11 (h) Policia e Kosovës (PK), përkatësisht Departamenti Kundër Krimin të Organizuar ka rritur bashkëpunimin dhe operacionet e përbashkëta me agjencitë e tjera, duke përfshirë edhe Policinë Kufitare të Kosovës dhe Doganat;</p> | |
| <p>2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë;</p> | <p>2.12. Sigurimi i zbatimit efektiv dhe efikas të vendimeve gjyqësore;</p> | <p>2.12 (a) Gjykata Evropiane e Auditorëve, në vitin 2012, ka vlerësuar se vetëm 40% e vendimeve të gjykatave në Kosovë janë zbatuar;</p> <p>2.12 (b) Ligji për procedurën përmbartimore dhe sistemi i ri i zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, do të kontribuojnë në masë të madhe në zbatimin e vendimeve të gjykatave;</p> <p>2.12 (c) Ministria e Drejtësisë (MD) ka miratuar Udhëzimin Administrativ 09/2014 për</p> | <p>2.12 (a) Duhet të rritet zbatimi i vendimeve të gjykatave;</p> <p>2.12 (c) Kosova duhet të sigurojë një mbikëqyrje adekuate të përmbartuesve privatë;</p> |

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>procedurat disiplinore të agjentëve privatë të zbatimit më 13 maj 2014. Ajo ka certifikuar edhe 14 zyrtarë përmbaues privatë në tremujorin e parë të vitit 2014;</p> | |
| <p>2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë;</p> | <p>2.13. Hartimi dhe shkëmbimi në kohën e duhur i statistikave të hollësishme për hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve të krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit, me autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionin Evropian dhe EULEX-in;</p> | <p>2.13 (a) Raportimi bëhet përmes Dialogut të Procesit të Stabilizim Asocimit (DPSA), Trupit Koordinues të Sundimit të Ligjit dhe raportimin për monitorimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave;</p> <p>2.13 (b) Në tetor të vitit 2009, është lidhur një marrëveshje teknike për Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (PK) dhe të dhënave për Imigacion ndërmjet PK-së dhe EULEX-it. Sipas kësaj marrëveshjeje, PK i ka ofruar informacione konfidenciale operative si dhe informacione mbi imigracionin, komponentes së EULEX-it. Më 16 korrik 2013, është nënshkruar Marrëveshja Teknike për shkëmbim të Informatave penale ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe EULEX-it, meqë rast deri tani janë shkëmbyer me dhjetra informacione kriminale ndërmjet PK-së dhe EULEX-it. Gjithashtu, siç kanë raportuar zyrtarët e EULEX-it gjatë një interviste me KIPRED, ndarja e informacioneve bëhet në ekipe të përziera dhe në përputhje me Protokollat e Informacionit;</p> <p>2.13 (c) Në mungesë të një baze të të dhënave të përshtatshme, të dhënat nga shumica e institucioneve janë dorëzuar në mënyra të ndryshme. Për shembull të dhënat e paraqitura nga policia janë të ndryshme nga ato të paraqitura nga prokuroria; Mekanizmi përcjellës i themeluar nga prokuroria shtetërore lehtëson këtë proces në masë të madhe;</p> | <p>2.13 (c) Duhet të hartohen dhe të shkëmbehen, në kohën e duhur me organet e BE-së, statistikave për hetimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit, përmes themelimit të bazës së duhur të të dhënave;</p> |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |
| <p>r2) Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit me fokus në rendin publik dhe sigurinë;</p> | <p>2.14. Zbatimi i legjislacionit ekzistues për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe forcimin e kapaciteteve të policisë për të krijuar dhe për të operuar një program për mbrojtjen e dëshmitarëve;</p> | <p>2.14 (a) Për të garantuar zbatimin e marrëveshjes dhe mandatin e ri të EULEX-it, Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është ndryshuar;</p> <p>2.14 (b) Neni 28 i Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve që hyri në fuqi në shtator të vitit 2012, i jep të drejtën institucioneve të sundimit të ligjit për të bashkëpunuar me shtetet e tjera për zhvendosjen e dëshmitarëve. Prandaj, duke pasur parasysh madhësinë e territorit të Republikës së Kosovës dhe luhatshmërinë e dëshmitarëve, ata duhen të zhvendosen, në mënyrë që t'u sigurohet më shumë siguri;</p> <p>2.14 (c) Në mënyrë që të vazhdohet me zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, në qershor të vitit 2014, u nënshkrua një Procedurë Standarde Operative (PSO) për përfundimin e programit të paraparë me ligj për mbrojtjen e dëshmitarëve. Me qëllim të rritjes së kapaciteteve në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, gjatë periudhës raportuese, janë zhvilluar 8 trajnime për 33 pjesëmarrësit që merren me mbrojtjen e dëshmitarëve. Zyrtarët e mbrojtjes së dëshmitarëve gjithashtu kanë marrë pjesë në një trajnim të avancuar për bashkëpunim ndërkombëtar të organizuar në Holandë, i cili gjithashtu rezultoi në dhënien e anëtarësimit për Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve (DMD) nga EUROPOL, për të hyrë në platformën e tij të ekspertizës për mbrojtjen e dëshmitarëve;</p> <p>2.14 (d) Drejtoria e sapo krijuar e Mbrojtjes së Dëshmitarëve ka një</p> | <p>2.14. (b) Duhet të konsiderohet zhvendosja ndërkombëtare e dëshmitarëve, si mjet më i përshtatshëm për rastet e ndjeshme;</p> <p>2.14 (d) Kosova duhet të ruajë kapacitetet në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, në drejtim të financimit dhe të personelit;</p> <p>2.14 (e) Qeveria duhet të forcojë bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me Mbrojtjen e Dëshmitarëve, në mënyrë që të lehtësojë</p> |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>staf të mjaftueshëm, ka buxhetin e saj, por asnjë klient ende nuk është marrë në programin e saj për mbrojtjen e dëshmitarëve apo është zhvendosur;</p> <p>2.14 (e) Për më tepër, në mënyrë që të rritet më tej bashkëpunimi ndër-institucional për mbrojtjen e dëshmitarëve, dy marrëveshje janë përfunduar në tremujorin e parë të vitit 2014: një në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), nënshkruar më 6 shkurt 2014, dhe një në mes të MPB-së dhe EULEX-it, nënshkruar më 11 mars 2014;</p> | <p>zhvendosjen e dëshmitarëve, nëse nevojitet;</p> |
|--|--|--|--|

III. Menaxhimi i Kufijve në lidhje me Krimin e Organizuar, duke përfshirë Migracionin e Parregullt dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore

| Fusha | Veprimet që duhet të ndërmerren (Treguesit) | Çfarë është bërë deri më tani? Treguesit janë marrë nga raportet e progresit të BE-së dhe Udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave për Kosovën, dhe nga monitorimi ynë në kuadër të këtij projekti | Çfarë duhet bërë më tutje/Rekomandimet |
|---|--|--|---|
| 3) Menaxhimi i kufijve në lidhje me krimin e organizuar, duke përfshirë migracionin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore; | 3.1. Përmirësimi i kontrollimit të kufijve (kontrollit dhe mbikëqyrjes) në dhe ndërmjet të gjitha pikave të kalimit kufitar, sidomos nëpërmjet analizave të zgjeruara të rrezikut dhe intelegjencës penale, për të siguruar një kontroll të personave, automjeteve dhe mallrave të kalimit dhe mbikëqyrjen efektive | <p>3.1 (a) Pikat e kalimit kufitar janë të pajisura në mënyrë të mjaftueshme për të kryer kontrole të linjës së parë dhe të dytë. Policia Kufitare dhe Doganat kanë personelin e mjaftueshëm për të kontrolluar flukset e trafikut dhe lëvizjen e pasagjerëve;</p> <p>3.1 (b) Në janar 2013, u krijua një Qendër Kombëtare për Menaxhim Kufitar. Kjo qendër është e përbërë nga stafi nga të gjitha autoritetet të</p> | <p>3.1 (a) Disa nga pajisjet e mbikëqyrjes dhe të infrastrukturës në pikat e kalimit kufitar duhet të përditësohen dhe mirëmbahen siç duhet, pra përdorimi i pajisjeve biometrike rregullisht;</p> <p>3.1 (b) Përdorimi i analizës së rrezikut, e cila nënkupton një përdorim sistematik të</p> |

| | | | |
|--|---|---|---|
| | <p>midis të gjitha pikave të kalimit kufitar;</p> | <p>lidhura me kufirin dhe është përgjegjëse për analizat strategjike të rrezikut operacional në nivel qendror, shkëmbimin e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave. Gjithashtu, gjatë vitit 2014 janë mbajtur takime të rregullta të përbashkëta të nivelit lokal dhe atij qendror për MIK-un. Gjithsej 178 takime janë mbajtur në PKK dhe Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Drejtoritë Rajonale të Doganës së Kosovës;</p> <p>3.1 (c) Gjatë periudhës së raportimit ka pasur përparim të rëndësishëm në lidhje me planet operative dhe operacionet e përbashkëta të kryera, si dhe të vlerësimit të problemeve. Bazuar në vlerësimet e rrezikut gjatë kësaj periudhe raportuese, janë hartuar tre plane operative për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK); Nga takimet që mbahen çdo muaj në nivel qendror, bazuar në rekomandimet e dhëna, Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Njësitë Qendrore përpilojnë Plane Operative për zbatimin e atyre detyrave si dhe raportojnë për realizimin e tyre.</p> <p>3.1 (d) Agjencitë në kuadër të Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK), kanë krijuar një mekanizëm të përbashkët të profilizimit dhe analizave të rrezikut dhe kërcënimeve për pikat e kalimit kufitar (PKK) dhe vijën e gjelbër dhe të kaltër dhe zhvillojnë raporte analitike në baza gjashtë mujore. Planifikimi strategjik, ndarja e personelit dhe burimeve teknike bazuar në një analizë të vazhdueshme të mjedisit dhe kërcënimeve janë duke u bërë vazhdimisht. Planifikimi dhe</p> | <p>informatave në dispozicion për të përcaktuar se sa shpesh mund të shfaqet rreziku dhe cilat janë përmasat dhe pasojat, duhet të shtohet, në mënyrë të veçantë në planifikimin e veprimeve operacionale;</p> <p>3.1 (e) Në nivel rajonal dhe lokal, analiza e rrezikut duhet të praktikohet në mënyrë sistematike për të përmirësuar planifikimin operacional, ndërtimin e kapaciteteve dhe një qasje proaktive për menaxhim të kufijve / kufirit administrativ; pra duhet të ketë kontrolle më të plotë të makinave dhe udhëtarëve, duke përfshirë kontroll të plotë të të rriturve dhe</p> |
|--|---|---|---|

| | | | |
|--|--|--|---|
| | | <p>aktivitetet e menaxhimit të kufijve të bazuara në intelgjencë janë duke u zhvilluar;</p> <p>Një Njësi e përbashkët e Analizës së Intelgjencës, Rrezikut dhe Kërcënimit është ngritur së bashku me tri autoritetet e MIK-ut. Kjo njësi brenda MIK, përgatit një raport përmbledhës të bazuar në vlerësimet taktike të të tre rajoneve dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP), në bazë të rregullt mujore dhe sipas zonës së përgjegjësisë së rajoneve të parashikuara në strukturë;</p> <p>3.1 (e) Është shënuar përparim i dukshëm në lidhje me vlerësimin e rrezikut: 1,783 vlerësime të rregullta të rrezikut dhe 26 vlerësime <i>ad hoc</i>, janë kryer gjatë vitit 2013, në krahasim me 136 vlerësime të rrezikut të rregullta dhe 1 vlerësim <i>ad hoc</i>, në tremujorin e parë të vitit 2014. Në tremujorin e dytë të vitit 2014, 169 vlerësime të rrezikut janë kryer në nivel lokal dhe 12 në nivel rajonal, ndërsa vetëm në korrik të vitit 2014, 13 vlerësime të rrezikut janë realizuar në nivel lokal dhe 4 në nivel rajonal;</p> <p>3.1 (f) Gjithashtu, me qëllim parandalimin e migracionit të parregullt dhe kontrabandën e personave, Policia kufitare ka filluar hartimin e planeve operative në bazë të analizës së vlerësimit të rrezikut dhe profilizimin e kompanive për udhëtarët, si dhe të udhëtarëve në bazë të treguesve të rrezikut;</p> | <p>dokumenteve të fëmijëve (përdorimi i autorizimeve për fëmijët kur udhëtojnë me një prind) për të parandaluar rastet e mundshme të rrëmbimit të fëmijëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore;</p> |
| <p>3)Menaxhimi i kufijve në lidhje me krimin e organizuar, duke përfshirë</p> | <p>3.2. Krijimi i pikave të përbashkëta të vendkalimit kufitar aty ku është e përshtatshme, për kontroll dhe mbikëqyrje të koordinuar të personave,</p> | <p>3.2 (a) Më 26 mars 2014 u nënshkrua një Memorandum i Mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi për hapjen e përbashkët të Pikë Kalimit Kufitar</p> | <p>3.2 (a) Kosova duhet të përpiqet për të përfunduar definimin/demarkacionin e kufirit me Malin e Zi; (është kryer)</p> |

| | | | |
|---|--|--|--|
| <p>migracionin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore;</p> | <p>automjeteve dhe mallrave që kalojnë, duke përfshirë përmes njësive të palëvizshme dhe të lëvizshme dhe të koordinuara të monitorimit dhe patrullimit;</p> | <p>(PKK) Kotllövë - Kuqishtë dhe kjo pritet të zbatohet duke filluar vitin e ardhshëm. Me 26 gusht 2015 në Vjenë, përfaqësues nga Republika e Kosovës dhe e Malit të Zi kanë nëshkruar marrëveshjen për demarkacion të kufirit;</p> <p>3.2 (b) Sa i përket kufijve me Maqedoninë, është duke u ndërtuar Pikë Kalimi i përbashkët Kufitar (PKK) Stanqiq / Bellanovc, i cili është projekt i financuar nga BE-ja;</p> <p>3.2 (c) Duke u bazuar në përfundimet e arritura për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) dhe lëvizjes së lirë, përmes ndërmjetësimit ndërkombëtar në Bruksel, përgjatë kufijve me Republikën e Serbisë është paraparë ndërtimi i gjashtë (6) objekteve të përbashkëta së bashku me infrastrukturën përcjellëse në Pikat e Kalimit të Kufirit (PKK). Të gjashtë PKK-të e përkohshme të MIK-ut me Serbinë janë funksionale. Është arritur një marrëveshje teknike për vendndodhjen e tyre të saktë, si dhe mbi draft planet për ndërtimin e pikave të përhershme të kalimit të MIK-ut. Ndërtesat e tilla të përbashkëta pritet të ndërtohen edhe në kufi me Malin e Zi;</p> <p>3.2 (d) Tri marrëveshjet e përbashkëta të kontrollit kufitar, të nënshkruara në vitin 2013, me Shqipërinë janë duke u zbatuar, si dhe Qendrat e Përbashkëta të Bashkëpunimit Policor, të vendosura në pikat kufitare me Shqipërinë, janë plotësisht operacionale. Patrulla të përbashkëta janë kryer me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë. Një paketë e marrëveshjeve bilaterale dhe e protokolleve, në fushën e kontrollit kufitar, është nënshkruar me Malin e Zi;</p> | <p>3.2 (c) Kosova dhe Serbia me mbështetjen e BE-së duhet të zbatojnë marrëveshjet teknike për ndërtimin e gjashtë objekteve të përbashkëta në Pikat e Kalimit Kufitar. Kjo gjë duhet të konsiderohet edhe për pikat e kalimit kufitar me Malin e Zi;</p> |
|---|--|--|--|

| | | | |
|---|---|--|--|
| <p>3)Menaxhimi i kufijve në lidhje me krimin e organizuar, duke përfshirë migracionin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore;</p> | <p>3.3. Zgjerimi i parandalimit, zbulimit dhe hetimit të krimeve të rënda ndërkufitare, në veçanti të trafikimit të qenieve njerëzore, migrimit të parregullt të lehtësuar, duke shkëmbyer me autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit të shteteve anëtare dhe vendeve të treta, në përputhje me kërkesat e brendshme për mbrojtjen e të dhënave dhe përmes kanalit të përshtatshëm, informacionin e nevojshëm strategjik dhe operacional dhe intelgjencës penale;</p> | <p>3.3 (a) Strategjia Kombëtare 2013-2018 për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) parasheh krijimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm me shërbimet doganore fqinje për të zbuluar në kohë dhe për të parandaluar aktivitetet ndërkombëtare penale. Ky sistem do të vendoset në të gjitha nivelet, një sistem i komunikimit të drejtpërdrejtë në nivelin lokal, ndërsa në nivel qendror nëpërmjet një komunikimi të mbrojtur dixhital. Strategjia Kombëtare për MIK-un 2013-2018, është rishikuar dhe harmonizuar me strategjitë dhe planet e veprimit të Strategjisë Nacionale Kundër Trafikimit me Njerëz, Strategjisë Kombëtare Kundër Krimit të Organizuar dhe Strategjisë Kombëtare për parandalimin e Krimit.</p> <p>3.3 (b) Në mënyrë që të rrisin më tej bashkëpunimin ndërkombëtar të zbatimit të ligjit, autoritetet përkatëse të Republikës së Kosovës (Policia e Kosovës, Doganat e Kosovës dhe Njësia për Intelgjencë Financiare) kanë nënshkruar 20 Marrëveshje dhe 10 Memorandume të Bashkëpunimit me 19 shtete në fushën e bashkëpunimit për zbatimin e ligjit. Kjo përfshin dy marrëveshje më të fundit të bashkëpunimit policor: një me Malin e Zi (përfunduar në mars 2014) dhe një me Zvicrën (në nëntor 2013);</p> <p>3.3 (c) Në mes të shërbimeve kufitare (jo të të gjitha shteteve) mbahen takime të rregullta mujore në nivel lokal. Takimet mbahen në nivel bilateral me përfaqësuesit e shteteve fqinje për çështje kufitare me iniciativë dhe organizim të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare që janë të</p> | <p>3.3. (b) Sipas nevojës, Kosova duhet të rishikojë mundësinë për të nënshkruar marrëveshje të tjera bashkëpunimi për zbatimin e ligjit, duke përfshirë të gjitha shtetet e rajonit;</p> |
|---|---|--|--|

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | <p>pranishme në këto vende. Takimet janë mbajtur dhe janë duke u mbajtur edhe në nivelin e bashkëpunimit multilateral për çështjet e Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK), të cilat janë të organizuara nga komuniteti ndërkombëtar. Poashtu në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së MIK-ut e dalë nga dialogu teknik në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, zhvillohen takimet të rregullta mujore në nivel regjional;</p> <p>3.3 (d) Komunikimi me agjencitë kufitare të shteteve rajonale ndryshon sipas shteteve. Në vendet më të zhvilluara fqinje, komunikimi ekziston në të gjitha nivelet e mundshme, ndërsa pjesa tjetër, përfshin vendet e botës së tretë, vetëm për shkëmbimin e informacionit me karakter zyrtar në lidhje me krimet ndërkufitare, migracionin e paligjshëm, kontrabandimin e mallrave, terrorizmin, etj.</p> <p>Me qëllim të zbatimit të marrëveshjeve rajonale, komunikimet janë të vendosura në tre nivele: nivel qendror / menaxherial, nivel sektorial dhe lokal. Për të rritur efikasitetin e lehtësisë të tregtisë ligjore, mbahen takime të rregullta në nivel lokal për të parandaluar dhe për të luftuar ekonominë joformale dhe kriminalitetin, informacioni ndahet në baza ditore si dhe mbahen takime të rregullta; ndërsa në lidhje me pyetjet e hapura, sugjerimet dhe vendosjen e politikave dhe strategjive të administrimit, mbahen takime dy herë në vit në mes të</p> | <p>3.3 (e) Të shqyrtohen modalitetet për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) për të vendosur bashkëpunim me Serbinë sidomos në paralajmërim zyrtar dhe raportimin e sëmundjeve të kafshëve, e cila është obligim i autoriteteve kompetente të të gjitha vendeve në rajon dhe më gjerë;</p> <p>3.3 (g) Të kryhen më shumë trajnime për rritjen e kapaciteteve të stafit në lidhje me planet operationale dhe të përbashkëta të veprimit, si dhe sistemet e komunikimit, gjë e cila do të mundësojë një kontroll më profesional dhe efikas të kufijve me fqinjët;</p> |
|--|--|---|---|

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>menaxherëve të nivelit të lartë;</p> <p>3.3 (e) Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka bashkëpunim me pikat e kalimit kufitar të shteteve fqinje, përveç me Republikën e Serbisë. Bashkëpunimi është i nevojshëm sidomos me paralajmërim zyrtar dhe raportimin e sëmundjeve të kafshëve, që është obligim i autoriteteve kompetente të të gjitha vendeve në rajon dhe më gjerë;</p> <p>3.3 (f) Autoritetet e Maqedonisë kanë rënë dakord se një Zyre e Shkëmbimit të Informacionit do të hapet në pikën qendrore Kosovë / Maqedoni;</p> <p>3.3 (g) Me qëllim të rritjes së efikasitetit të menaxhimit të kufirit, Policia Kufitare (PK) ka për qëllim që në të ardhmen të zhvillojë planet e përbashkëta të veprimit dhe operacionale në rast të situatave të ndryshme dhe të sistemit të komunikimit me vendet fqinje;</p> <p>3.3 (h) Të dhënat më të fundit nga EUROSTAT, tregojnë se gjatë periudhës Janar 2014 deri në Prill 2015, numri i azilkërkuesve të Kosovës në shtetet anëtare të BE-së ka qenë 56.785. Nga ana tjetër, shifrat e EUROSTAT për vitin 2014 tregojnë për 35.950 azilkërkues kosovar;</p> | |
| <p>3)Menaxhimi i kufijve në lidhje me krimin e organizuar, duke përfshirë migracionin e</p> | <p>3. 4. Forcimi i kapaciteteve të qendrës së bashkërendimit të brendshëm për të koordinuar bashkëpunimin operacional ndërmjet të</p> | <p>3.4 (a) Në shtator të vitit 2013, Ligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror ishte përafuar me <i>acquis</i>, si dhe Ligji i ri për Bashkëpunim Ndërmjet Agjencive hyri në fuqi;</p> | |

| | | | |
|--|--|---|--|
| <p>parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore;</p> | <p>gjitha autoriteteve vendore të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK), përfshirë mbikëqyrjen;</p> | <p>3.4 (b) Sa i përket menaxhimit të kufirit, shumica e strukturave për menaxhimin e integruar të kufirit (MIK) tani janë në vend. Të tri agjencitë e kufirit të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit (policia kufitare, doganore dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë) bashkëpunojnë nëpërmjet Bordit Kombëtar Ekzekutiv të MIK nën udhëheqjen dhe drejtimin e koordinatorit kombëtar;</p> <p>3.4 (c) Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufijve është themeluar në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Qëllimi kryesor i qendrës është monitorimi i lëvizjes së personave, automjeteve dhe mallrave në pikat e kalimit kufitar (PKK), gjithashtu edhe zbulimi dhe parandalimi i veprimeve të paligjshme që janë të definuara me ligj. Aktualisht, në procesin e Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK), Kosova ka angazhuar një staf prej 1.668 personave, prej të cilëve: 1,303 janë pjesëtar të Policisë Kufitare; 332 pjesëtar të Doganës së Kosovës; dhe 33 pjesëtar të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.</p> <p>Qendra për menaxhimin e kufijve është trupi i vetëm bashkëpunues rolet dhe përgjegjësitë e të cilit janë të rregulluara në mënyrë adekuate në ligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit dhe aktet nënligjore;</p> <p>3.4 Po ashtu, gjate vitit 2014 në fushën e MIK-ut janë hartuar dhe miratuar të gjitha procedurat standarde të operimit (PSO-të) që rrjedhin nga Ligji për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira</p> | <p>3.4 (c) Me qëllim të rritjes së kontrollit kufitar, numri i zyrtarëve të Doganave duhet të rritet në disa pika të kalimit kufitar;</p> <p>3.4 (d) Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufijve ende duhet të bëhet plotësisht operacionale dhe në përputhje me Planin e Zhvillimit. Kjo qendër përballet me sfida në bashkëpunim në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar me shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën. Duhet të ketë qasje më proaktive në zbatimin e Planit Zhvillimor për Menaxhimin e Kufijve;</p> |
|--|--|---|--|

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>në MIK dhe ligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror. Nga ligji për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK janë miratuar këto PSO :</p> <ul style="list-style-type: none"> · PSO- Shfrytëzimi i perbashkët i paisjeve në kuadër të MIK-ut, 26.02.2014 · Doracaku i komunikimit ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK, 25.02 2014 · PSO -Aktivitetet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve të përfshira në MIK, 26.02.2014 · PSO- Profilimi në PKK, 25.02.2014 · PSO -Kontrollimi në vijën e dytë, 06 02 2014 · PSO -Zyrtari i parë në rast, 25. 02. 2014 · PSO- Analiza e përbashkët e riskut në PKK dhe vijen kufitare, 26.02.2014 · PSO-Konfiskimin e mallrave dhe kafshëve të kontrabanduara, 02.07.2014; <p>3.4 (d) Në prill të vitit 2014 është miratuar një draft Plan i Zhvillimit (për periudhën 2014-17). Më tej në planin e zhvillimit për Qendrën Kombëtare për Menaxhimin e Kufijve (QKMK), Dogana e Kosovës (DK) ka ri-nisur linjën telefonike kundër-kontrabandë / kundër-korrupsion apo ndonjë veprimtari tjetër të paligjshme, e cila është e lidhur direkt me QKMK. Që atëherë, Qendra ka marrë 67 thirrje vetëm gjatë prillit të vitit 2014, përderisa kishte vetëm 80 thirrje të marra gjatë tërë vitit 2013. Në mënyrë të ngjashme, është arritur një marrëveshje ndërmjet QKMK dhe</p> | |
|--|--|---|--|

| | | | |
|---|--|---|---|
| | | <p>Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP), e cila i lejon QKMK-së qasje të drejtpërdrejtë në kamerat e sigurisë së aeroportit , duke rritur kapacitetin e mbikëqyrjes së Qendrës dhe si rezultat sigurinë dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve;</p> <p>3.4 (e) Në bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK), nga 1 maji deri me 31 korrik të vitit 2014, punonjësit e doganës së bashku me policinë kufitare kanë zbuluar 14 raste të narkotikëve, municione, armë, etj;</p> | |
| <p>3)Menaxhimi i kufijve në lidhje me krimin e organizuar, duke përfshirë migracionin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore;</p> | <p>3. 5. Zhvillimi i programeve të trajnimit për kundër-korrupsion dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe vendosja e një kodi etik për zyrtarët e përfshirë në Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK);</p> | <p>3.5 (a) Për shkak të natyrës së detyrave të tyre dhe ndërveprimit të tyre të shpeshtë me publikun, agjencitë e menaxhimit të kufijve janë veçanërisht të pambrojtura ndaj korrupsionit. Në këtë drejtim secila agjenci e përfshirë në Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) kanë në fuqi një Kod të dakorduar të Etikës shoqëruar me masa shtesë parandaluese kundër korrupsion;</p> <p>3.5 (b) Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK) e vitit 2012 është rishikuar, dhe Strategjia e re për MIK 2013-2018 është në fuqi tani, në përputhje me standardet e BE-së. Strategjia 2013-2018, parasheh trajnime në fushën e kundër-korrupsionit dhe krimit të organizuar. Përveç kësaj, autoritetet e përfshira në MIK kanë kurrikulumet e tyre të trajnimeve dhe kanë vazhduar ofrimin e trajnimeve për disa zyrtarë. Vetëm në vitin 2014, 121 zyrtarë të policisë kufitare kanë marrë pjesë në 10 trajnime mbi kundër-korrupsionin dhe krimin e organizuar. Gjithashtu, pothuajse të gjithë zyrtarët nga</p> | <p>3.5 (b) Të zbatohet Strategjia e re për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, e cila parasheh trajnime në fushat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Edhe pse, një numër i trajnimeve kanë ndodhur tashmë, ky numër duhet të rritet edhe më tej, në mënyrë që të trajnohet sa më shumë staf;</p> |

| | | | |
|--|---|---|---|
| | | <p>autoritetet e përfshira në MIK janë trajnuar në Kodin e Etikës. Trajnimet janë zhvilluar edhe për zyrtarët në nivel lokal (rajonin e Pejës dhe Gjakovës) dhe janë mbajtur në Kosovë dhe jashtë vendit;</p> | |
| <p>3) Menaxhimi i kufijve në lidhje me krimin e organizuar, duke përfshirë migracionin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore;</p> | <p>3.6. Hartimi dhe shkëmbimi në kohën e duhur i statistikave të detajuara me autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionin Evropian dhe EULEX-in në masat e kontrollit kufitar duke përfshirë numrin e operacioneve të koordinuara të monitorimit dhe patrullimit;</p> | <p>3.6 (a) Puna e Policisë Kufitare është e monitoruar nga EULEX-i dhe Komisioni Evropian (KE) me anë të mekanizmave të tyre në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar (PKK) me Serbinë, ku zyrtarët e EULEX-it janë të pranishëm 24 orë dhe monitorojnë punën e Policisë së Kosovës. Policia e Kosovës raporton në baza të rregullta dhe periodike dhe ndanë statistikatat me të gjitha organizatat ndërkombëtare, të tilla si FRONTEX, UNHCR, IOM, Projektin e Binjakëzimit që vepron në kuadër të Komisionit Evropian dhe kështu me radhë;</p> <p>3.6 (b) Raportimi nga institucionet e zbatimit të ligjit të Kosovës bëhet përmes Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit (DPSA), Trupit Koordinues për Sundimin e Ligjit dhe raportimin për monitorimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave; Gjithashtu, siç është raportuar nga zyrtarët e EULEX-it ndarja e informacionit bëhet në ekipe të përziera dhe në përputhje me Protokollin e Informacionit;</p> | |
| <p>3) Menaxhimi i kufijve në lidhje me krimin e organizuar, duke përfshirë migracionin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore;</p> | <p>3.7. Duhet të shqyrtohen modalitetet e bashkëpunimit me FRONTEX-in;</p> | <p>3.7 (a) Kosova ka filluar bashkëpunimin me FRONTEX në shkëmbimin e informacionit, analizat e rrezikut, ndërtimin e kapaciteteve dhe trajnimin. Në vitin 2013, Kosova ka emëruar një pikë qendrore për analizën e rrezikut në Policinë e Kosovës, e cila është përgjegjëse për mbajtjen e kontakteve të drejtpërdrejta me FRONTEX-in;</p> | <p>3.7 (b) Kosova duhet të shqyrtojë mundësinë që të bëhet shtet vëzhgues në FRONTEX, në qoftë se anëtarësimi i plotë nuk është i mundshëm për momentin;</p> |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>3.7 (b) Sa i përket bashkëpunimit me FRONTEX-in, në nëntor të vitit 2013, një delegacion i lartë i FRONTEX-it vizitoi Njësinë e Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufijve (QKMK) për Vlerësimin dhe Analizën e Rrezikut, duke shprehur interes të bashkëpunojnë në shkëmbimin e informacionit dhe duke siguruar ndërtimin e kapaciteteve;</p> | |
|--|--|--|--|

IV. Bashkëpunimi në Zbatimin e Ligjit

| Fusha | Veprimet që duhet të ndërmerren (Treguesit) | Çfarë është bërë deri më tani? Treguesit janë marrë nga raportet e progresit të BE-së dhe Udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave për Kosovën, dhe nga monitorimi ynë në kuadër të këtij projekti | Çfarë duhet bërë më tutje/Rekomandimet |
|--|---|--|--|
| 4) Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit; | 4.1. Rritja e parandalimit, zbulimit dhe hetimit të krimeve të rënda ndërkufitare, në veçanti të trafikimit të qenieve njerëzore , lehtësimit të migrimit të parregullt , duke shkëmbyer informacione me autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit të shteteve anëtare dhe vendeve të treta , në përputhje me kërkesat e brendshme për mbrojtjen e të dhënave dhe nëpërmjet kanaleve të përshtatshme , informacionin e nevojshëm strategjik dhe operacional si dhe atë të inteligjencës penale; | 4.1 (a) Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale është miratuar në korrik të vitit 2012; 4.1 (b) Bashkëpunimi strategjik dhe operacional i Kosovës me vendet fqinje dhe shtetet anëtare të BE-së sa i përket bashkëpunimit në zbatimin e ligjit funksionon në baza joformale; 4.1 (c) Kosova ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me policitë e Austrisë, Suedisë, Kroacisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë; marrëveshje për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore me Francën dhe Maqedoninë; një marrëveshje për bashkëpunim në fushën e sigurisë me Gjermaninë; dhe një marrëveshje për të | 4.1 (b) Kosova duhet të vazhdojë thellimin e bashkëpunimit për zbatimin e ligjit me të gjitha vendet e interesuara, si ato fqinje ashtu dhe me shtetet anëtare të BE-së; 4.1 (c) Kosova duhet të arrijë marrëveshje të mëtejshme në fushën e bashkëpunimit për zbatimin e ligjit me vende të tjera; |

| | | | |
|--|--|--|---|
| | | <p>luftuar krimin e organizuar dhe migracionin e parregullt me Hungarinë. Kosova ka marrëveshje bashkëpunimi me doganat e dhjetë vendeve te ndryshme;</p> <p>4.1 (d) Protokolli mbi Bashkëpunimin në Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në mes të Kosovës dhe Malit të Zi është nënshkruar më 25 prill 2014, në Prishtinë, Kosovë; (Informacione të mëtejshme për bashkëpunimin me vendet e tjera do të përditësohet)</p> <p>4.1 (e) Sipas zyrtarëve të Policisë së Kosovës, shkëmbimi i informacionit kryhet nëpërmjet kanaleve të Interpolit, atashëve policorë të akredituar në Kosovë, dhe tani përmes tre zyrtarëve ndërlidhës të policisë së Kosovës që janë të akredituar në Austri, Francë dhe Turqi (të planifikuar edhe për Gjermani dhe Belgjikë). Mosanëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare, të tilla si INTERPOL, EUROPOL, FRONTEX dhe SELEC, si dhe pamundësia e nënshkrimit të konventave të tilla, si Konventa e Bashkëpunimit Policor, mbetet sfidë;</p> | <p>4.1 (e) Kosova, e ndihmuar nga BE-ja, duhet të synojë që ta marrë (të paktën) statusin e vëzhguesit në këto organizata (INTERPOL, EUROPOL, FRONTEX, SELEC), në mënyrë që të avancojë më tej shkëmbimet e informacionit;</p> |
|--|--|--|---|

| | | | |
|---|--|--|--|
| | | <p>4.1 (f) Përmirësim i vazhdueshëm në parandalimin dhe zbulimin ndërkufitar të krimit të organizuar është i dukshëm. Statistikat e Policisë Kufitare dhe raportet e ekspertëve, tregojnë një trend të qëndrueshëm në rritjen e arrestimeve në lidhje me veprat penale (nga 815 në vitin 2012 në 1,186 në vitin 2013 dhe 250 në tremujorin e parë të vitit 2014);</p> | |
| <p>4) Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit;</p> | <p>4. 2. Krijimi i një marrëveshje me EULEX-in për shkëmbim të sigurt, të besueshëm dhe efikas të informatave strategjike dhe operative dhe intelegjencës penale, të nevojshme për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimeve të rënda;</p> | <p>4.2 (a) Sa i përket bashkëpunimit me EULEX-in, letrat e shkëmbyera mes Presidentes së Kosovës dhe të Përfaqësueses së Lartë të BE-së, më 23 prill 2014 janë ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, si marrëveshje ndërkombëtare e mundësuar përmes Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Për më tepër, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës me 23 prill 2014. Këto dy ligje parashohin dispozita që lejojnë EULEX-in të mbajë juridiksionin në</p> | |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>rastet që përfshijnë krimet e luftës , terrorizmit, krimet të organizuar, dhe rastet serioze të korrupsionit;</p> <p>4.2 (b) Bashkëpunimi i Policisë së Kosovës (PK), prokurorëve dhe gjyqtarëve me homologët e tyre të EULEX-it, është raportuar të jetë në nivel të kënaqshëm. Në këtë drejtim, PK-ja është e gatshme të marrë pjesë në bashkëpunim ndërkombëtar dhe për të punuar ngushtë me EULEX-in në luftimin e krimet të organizuar;</p> <p>4.2 (c) Në tetor të vitit 2009, është nënshkruar një marrëveshje teknike për Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës dhe të dhënat e migracionit në mes të Policisë së Kosovës (PK) dhe EULEX-it. Sipas kësaj marrëveshjeje, PK-ja ka ofruar informata operative lidhur me emigracionin për EULEX. Me 16 korrik 2013, një Marrëveshje Teknike u nënshkrua për shkëmbimin e informacionit penal në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe EULEX-it , e që deri më tani ka rezultuar në ndarjen e dhjetra e informatave, të shkëmbyera mes PK-së dhe</p> | <p>4.2 (c) Policia e Kosovës (PK) dhe EULEX-i duhet të krijojnë një marrëveshje për shkëmbim të sigurt, të besueshëm dhe efikas të informatave strategjike dhe operative si dhe intelegjencës penale, të nevojshme për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimeve të rënda;</p> |
|--|--|--|--|

| | | | |
|---|--|---|---|
| | | <p>EULEX-it për çështjet penale, gjë që është në interesin e të dy palëve.</p> <p>PK-ja, gjithashtu, kohët e fundit ka mundësuar qasjen e EULEX-it në sistemin e informacionit të PK-së dhe sistemin e menaxhimit të kufirit, gjë që kontribuon në hetimin e krimeve të rënda në Kosovë;</p> <p>4.2 (d) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka nënshkruar dy marrëveshje me Misionin e EULEX-it, më 18 korrik dhe 12 gusht 2014, në funksion të zbatimit të ligjit për mandatin e ri të EULEX-it;</p> | |
| <p>4) Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit;</p> | <p>4.3. Rritja e bashkëpunimit operacional me autoritetet e zbatimit të ligjit të shteteve anëtare dhe vendeve të treta, veçanërisht duke kryer hetime dhe operacione të përbashkëta;</p> | <p>4.3 (a) Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit në Ministrinë e Drejtësisë po vazhdon të kryejë funksionet e saj në mënyrë profesionale;</p> <p>4.3 (b) Kosova ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me policitë e Austrisë, Suedisë, Kroacisë, Shqipërisë dhe Maqedonisë; marrëveshje për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore me Francën dhe Maqedoninë; një marrëveshje për</p> | <p>4.3 (a) Autoritetet e zbatimit të ligjit në nivel lokal (rajoni i Pejës dhe Gjakovës) duhet të rrisin bashkëpunimin me Njësinë e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit në Ministrinë e Drejtësisë;</p> <p>4.3 (b) Kosova duhet të vazhdojë thellimin e bashkëpunimit për zbatimin e ligjit me të gjitha vendet e interesuara, si ato fqinje ashtu dhe shtetet anëtare të BE-së, duke nënshkruar memorandume mirëkuptimi në luftimin e trafikimit të</p> |

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | <p>bashkëpunim në fushën e sigurisë me Gjermaninë; dhe një marrëveshje për të luftuar krimin e organizuar dhe migracionin e parregullt me Hungarinë. Kosova ka marrëveshje bashkëpunimi me doganat e dhjetë vendeve të ndryshme;</p> <p>4.3 (c) Kosova ka kryer një numër të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta me shtetet fqinje si Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi, si dhe Austria, Italia, dhe Suedia. Hetimet e përbashkëta për krimin e organizuar dhe krimet e rënda, të kryera nga Drejtoria e Krimin të Organizuar të Policisë së Kosovës, së bashku me homologët e tyre shqiptarë, maqedonas dhe malazezë, është rritur përgjatë viteve, nga 4 në vitin 2011, 6 në vitin 2012 dhe në 17 në vitin 2013;</p> <p>4.3 (e) Në vitin 2013, Policia e Kosovës (PK) ka realizuar 17 takime operative dhe 2 operacione të përbashkëta. Në vitin 2014, deri më tani, Policia e Kosovës ka realizuar 10 takime operacionale, që kanë</p> | <p>qenieve njerëzore, krimin të organizuar dhe migrimit jo të rregullt;</p> |
|--|--|---|---|

| | | | |
|--|---|---|---|
| | | rezultuar në hetime të përbashkëta; | |
| 4) Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit; | 4.4 Përmirësimi i kapaciteteve hetimore, bazuar në intelgjencë, të organeve të zbatimit të ligjit për të hetuar krimet e rënda ndërkufitare; | 4.4 (a) Në mars të vitit 2013, qeveria miratoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Policimin e Udhëhequr nga Intellegjenca për vitet 2013-2014; 4.4 (b) Policimi i udhëhequr nga intellegjenca mbetet i dobët. Sistemi i tanishëm i Informacionit të Policisë së Kosovës (PK) nuk e përfshin informacionin e dorëzuar nga zyrtarët e PK-së dhe nuk kontribuon në analizën efektive, e cila është thelbësore për policimin e udhëhequr nga intellegjenca, për të ekspozuar dhe për të hetuar krimin e organizuar; | 4.4 (a) Përmirësimet e mëtejshme mbi policimin e udhëhequr nga intellegjenca duhet të maten në bazë të rezultateve; 4.4 (b) Duhet përmirësuar shkëmbimin e informatave në mes të autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe atyre gjyqësore, lidhur me policimin e udhëhequr nga intellegjenca; duhet forcuar kapacitetet e tyre dhe burimet njerëzore; 4.4 (c) Një model funksional i intelgjencës (grumbullimi efektiv, analizimi dhe shpërndarja e informacionit) duhet të zhvillohet, për të krijuar një tablo të plotë të krimin të organizuar, duke detajuar kërcënimet dhe trendet në rrjetet dhe grupet kriminale; |
| 4) Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit; | 4.5. Hartimi dhe ndarja, në kohën e duhur, e statistikave të hollësishme për shkëmbimin e informacionit në fushën e zbatimit të ligjit, | 4.5 (a) Dy marrëveshje teknike mbi bashkëpunimin me EULEX-in janë arritur, përkatësisht në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe në shkëmbimin e informacionit me qëllim të | 4.5 (a) Sipas nevojës, duhet të lidhen marrëveshje të tjera me EULEX-in në fushën e bashkëpunimit për zbatimin e ligjit; |

| | | | |
|--|--|---|---|
| | <p>hetimeve të përbashkëta dhe operacioneve të përbashkëta, me autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it;</p> | <p>parandalimit dhe zbulimit të krimit në Kosovë;</p> <p>4.5 (b) Zyrtarët e EULEX-it kanë deklaruar se ndarja e informacionit është bërë në ekipe të përziera, dhe në pajtim me Protokollin e Informacionit; Për më tepër, shkëmbimi i të dhënave është bërë edhe në forumet e organizuara nga institucionet e Kosovës, ku EULEX-i dhe organizatat ndërkombëtare janë të ftuar të marrin pjesë;</p> <p>4.5 (c) Raportimi nga institucionet e zbatimit të ligjit të Kosovës bëhet edhe përmes Dialogut për Procesin e Stabilizimit Asociimit (DPSA), Tërupit Koordinues të Sundimit të Ligjit si dhe përmes raportimit mbi monitorimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave;</p> | <p>4.5 (c) Siç është raportuar, në mungesë të një databaze të duhur, të dhënat që institucionet e zbatimit të ligjit i kanë dërguar BE-së, nuk kanë qenë të standardizuara, rrjedhimisht kanë qenë jo koherente. Për shembull të dhënat e paraqitura nga ana e policisë janë të ndryshme nga ato të paraqitura nga prokuroria. Institucionet e Kosovës duhet të zhvillojnë një bazë të duhur të të dhënave sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të krijojnë një proces të rregullt raportimi dhe shkëmbimi të informacionit, në vend të përgjigjeve <i>ad hoc</i>;</p> |
|--|--|---|---|

| | | | |
|---|--|--|--|
| <p>4) Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit;</p> | <p>4. 6. Kosova duhet të shqyrtojë modalitetet e bashkëpunimit me EUROPOL-in;</p> | <p>4.6 (a) Nuk ka asnjë marrëveshje operationale dhe strategjike në mes të Kosovës dhe EUROPOL-it. Kosova bashkëpunon me EUROPOL-in dhe INTERPOL-in me anë të ndërmjetësimit të BE-së dhe OKB-së.</p> <p>Megjithatë, ka shkëmbime të rregullta informacioni me këto agjenci përmes BE-së dhe OKB-së. Kosova ka qenë e përfshirë në tri operatione të përbashkëta me EUROPOL-in;</p> <p>4.6 (b) Pasi që Kosova nuk është shtet anëtar i EUROPOL-it dhe EUROJUST-it, ajo bashkëpunon me këto agjenci përmes disa projekteve që ata kanë në Ballkanin Perëndimor;</p> <p>4.6 (c) Siç është raportuar nga zyrtarët e EULEX-it, EULEX-i është duke vlerësuar mundësinë për të nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit me EUROPOL-in, pasi që Kosova nuk është anëtare e BE-së. Kjo agjendë do të transferohet në Zyrën e BE-së, potencialisht deri më 15 tetor 2014;</p> | <p>4.6 (a) Kosova duhet ta rrisë vazhdimisht bashkëpunimin me EUROPOL-in; Transferimi i kompetencave nga EULEX-i tek zyra e re e BE-së duhet të finalizohet sa më shpejt që është e mundur;</p> |
| <p>4) Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit;</p> | <p>4. 7. Kosova duhet të shqyrtojë mundësitë e bashkëpunimit me nismat rajonale, sa i</p> | <p>4.7 (a) Kosova ka kërkuar lidhje më të ngushta me organizatat rajonale për bashkëpunim në fushën e</p> | <p>4.7 (a) Kosova duhet të shqyrtojë rrugët e bashkëpunimit me nisma të tjera rajonale për zbatimin e</p> |

| | | | |
|--|--|---|--|
| | përket bashkëpunimit në fushën e zbatimit të ligjit; | zbatimit të ligjit si: Qendra për Zbatimin e Ligjit në Evropën Juglindore, Shoqata e Shefave të Policive të Evropës Juglindore si dhe Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore; | ligjit; |
| 4) Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit; | 4.8. Zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese për sa i përket bashkëpunimit në fushën e zbatimit të ligjit, dhe kur është e përshtatshme, lidhja e marrëveshjeve të reja; | <p>4.8 (a) Në vitin 2013, Kosova ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe memorandume të mirëkuptimit në fushën e Bashkëpunimit për Zbatimin e Ligjit me Hungarinë , Finlandën, Zvicrën dhe Italinë;</p> <p>4.8 (b) Në mënyrë që të rritet më tej bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit, autoritetet përkatëse (Njësia për Intelgjencë Financiare, Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës) të Republikës së Kosovës kanë nënshkruar 20 marrëveshje dhe 10 Memorandume Mirëkuptimi me 19 shtete, në fushën e Bashkëpunimit për Zbatimin e Ligjit. Këtu përfshihen dy marrëveshjet e fundit të bashkëpunimit policor: një me Malin e Zi (arritur në mars të vitit 2014) dhe një me Zvicrën (në nëntor të vitit 2013);</p> | 4.8 (a) Duhet të zbatohen marrëveshjet ekzistuese në fushën e Bashkëpunimit për Zbatimin e Ligjit, dhe kur është e përshtatshme, të lidhen marrëveshje të reja; |

V. Sistemi Gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar)

| Fusha | Veprimet që duhet të ndërmerren (Treguesit) | Çfarë është bërë deri më tani? | Çfarë duhet bërë më tutje/Rekomandimet |
|---|---|--|--|
| <p>5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar);</p> | <p>5. 1. Zbatimi i legjislacionit ekzistues për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale si dhe zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale dhe, kur është e përshtatshme, lidhja e marrëveshjeve të reja;</p> | <p>5.1 (a) Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale, u miratua më 31 Korrik 2013. Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zbatimin e Ligjit në Ministrinë e Drejtësisë vazhdon të kryejë funksionet e saj në nivel të kënaqshëm;</p> <p>5.1 (b) Buxheti për Departamentin e Kosovës për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBJN) është rritur në krahasim me vitet e mëparshme, pas rritjes së numrit të kërkesave nën titullin e ndihmës së ndërsjellë juridike ndërkombëtare. DBJN ofron bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile, si dhe harton dhe negocion marrëveshjet dypalëshe në këtë fushë. Për të përmirësuar zbatimin e këtyre marrëveshjeve, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) kanë caktuar pika kontakti në</p> | <p>5.1 (a) Zbatimi i legjislacionit ekzistues duhet bërë nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe. Duhet bërë vlerësimi se deri në çfarë mase këto marrëveshje e kanë mbështetur, në mënyrë efektive, zbatimin e ligjit;</p> <p>5.1 (c) Sipas nevojës, duhet lidhur më tej marrëveshje mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale me shtetet fqinje dhe shtetet anëtare të BE-së;</p> |

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | <p>çdo zyrë të gjykatës dhe të prokurorisë për të trajtuar raste lidhur me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale. Në shkurt, një zyrtar tjetër ligjor ishte rekrutuar në DBJN;</p> <p>5.1 (c) Kosova ka lidhur marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë juridike me Kroacinë, Maqedoninë dhe Turqinë; marrëveshje për ekstradim me këto të fundit me përjashtim të Kroacisë, marrëveshje për transferimin e personave të dënuar me Belgjikën, Zvicrën, Maqedoninë dhe Turqinë. Negociatat me Gjermaninë, Italinë dhe Shqipërinë kanë përfunduar për ndihmën e ndërsjellë juridike, ekstradimin dhe transferimin e personave të dënuar;</p> <p>5.1 (d) Kosova ka lidhur marrëveshje dhe Memorandume Mirëkuptimi për bashkëpunim në shkëmbimin e informacionit inteligjent financiar lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit me vendet e mëposhtme: Turqi, Finlandë, Slloveni, Maqedoni, Shqipëri, Mali të Zi, San Marino dhe Republikën Çeke;</p> <p>5.1 (e) Kosova gjithashtu ka lidhur marrëveshje dhe Memorandume Mirëkuptimi për bashkëpunim dhe ndihmë</p> | <p>5.1 (d) Sipas nevojës, duhet lidhur më tej marrëveshje dhe Memorandume Mirëkuptimi për bashkëpunimin në shkëmbimin e intelgjencës financiare me vendet e tjera fqinje dhe shtetet anëtare të BE-së;</p> <p>5.1 (e) Sipas nevojës, duhet lidhur më tej marrëveshje dhe Memorandume Mirëkuptimi për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në çështjet doganore me vendet e tjera fqinje dhe shtetet anëtare të BE-së;</p> |
|--|--|---|---|

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>të ndërsjellë në çështjet doganore me Turqinë, Slloveninë, Poloninë, Malin e Zi, Maqedoninë, Italinë, Hungarinë, Austrinë, Shqipërinë dhe Francën;</p> <p>5.1 (f) Në mënyrë që të rritet më shumë bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar, Departamenti i Ministrisë së Drejtësisë (MD) për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, në qershor të vitit 2013 nënshkroi një marrëveshje me Italinë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale dhe ekstradim, ndërsa marrëveshja me Gjermaninë mbi bashkëpunimin gjyqësor do të përfundojë së shpejti. Negociatat po vazhdojnë me Malin e Zi, Slloveninë dhe Kroacinë, dhe së shpejti do të fillojnë me Hungarinë, Austrinë dhe Bullgarinë;</p> <p>5.1 (g) Që nga themelimi i Njësisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Zbatimin e Ligjit (NJBZL) në qershor të vitit 2011 deri në fund të dhjetorit 2013, ka pasur 8523 raste të aktiviteteve të bashkëpunimit rajonal, duke përfshirë edhe takimet operative që përfshijnë rastet e krimit ekonomik dhe korrupsionit,</p> | |
|--|--|---|--|

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>kontrabandimit të emigrantëve, trafikimit të qenieve njerëzore, trafikut të drogës dhe terrorizmit. Në tremujorin e dytë të vitit 2014, Policia e Kosovës (PK), e NJBNZL ka pranuar 715 kërkesa, ndërsa në korrik të vitit 2014, 156 kërkesa janë dërguar në NJBNZL. Në mesin e këtyre kërkesave, NJBNZL ka trajtuar 5 raste të ekstradimit, 12 raste të ndalimit të ndryshimit të të dhënave personale dhe 27 raste që kanë të bëjnë me verifikimin e personave për t'u ripranuar. Kërkesat tjera i përkasin verifikimit të automjeteve, identitetit, prapavijës, statusit etj;</p> <p>5.1 (i) Në lidhje me vendosjen e zyrtarëve ndërlidhës të policisë në misionet diplomatike të Kosovës, gjatë kësaj periudhe, tre (3) zyrtarë të tillë janë pozicionuar në kryeqytetet e mëposhtme: Vjenë, Ankara dhe Bruksel;</p> <p>5.1 (j) Më 17 shkurt 2014, dy (2) zyrtarë ndërlidhës janë dërguar në Austri dhe Francë. Tre (3) zyrtarët e ardhshëm (për Belgjikë, Gjermani dhe Turqi) do të dërgohen deri në mesin e vitit 2014;</p> | |
|--|--|--|--|

| | | | |
|---|--|---|---|
| <p>5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar);</p> | <p>5.2. Miratimi dhe zbatimi i masave që synojnë përmirësimin e efektivitetit, efikasitetit dhe paanshmërisë së bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale me shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e treta;</p> | <p>5.2 (a) Më 31 korrik 2013, Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar është miratuar nga Kuvendi dhe ofron një bazë ligjore për ndihmën e ndërsjellë juridike me vendet e treta;</p> | <p>5.2 (a) Të zbatohet më tej Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar;</p> |
| <p>5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar);</p> | <p>5.3. Zbatimi i marrëveshjes teknike me EULEX-in për ndihmën e ndërsjellë juridike në lidhje me rastet e ndërlikuara të krimit të organizuar;</p> | <p>5.3 (a) EULEX-i vazhdon të veprojë si ndërmjetës me shtetet jo-njohëse sipas kushteve të definuara në marrëveshjet teknike, nën Ministrinë e Drejtësisë. Kosova i ka dërguar disa kërkesa Serbisë për bashkëpunim të ndërsjellë juridik, por Serbia nuk ka pranuar bashkëpunimin për shkak të mosnjohjes së Kosovës si shtet dhe çështjes së reciprocitetit;</p> <p>5.3 (b) Në bazë të marrëveshjes teknike për ndihmë të ndërsjellë juridike në mes të Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe EULEX-it, nga shtatori i vitit 2013 e deri në prill të vitit 2014, EULEX-i ka transmetuar 93 kërkesa dhe përgjigje nga Kosova për në shtetet jo-njohëse (me përjashtim të Serbisë) si dhe 90 kërkesa dhe përgjigje, shtetet jo-njohëse (përveç Serbisë) ia kanë transmetuar Kosovës përmes EULEX-it. Në kuadër të dialogut Prishtinë-Beograd, të lehtësuar nga BE-ja (bazuar në procedurat për ndihmë të ndërsjellë juridike në mes të Kosovës dhe Serbisë, të datës 20 mars 2013), nga shtatori i vitit 2013 deri në mes të</p> | <p>5.3 (a) Nën monitorimin dhe lehtësimin e BE-së, qeveria e Kosovës duhet të adresojë më tej çështjen e refuzimit të Serbisë për bashkëpunim të ndërsjellë juridik në procesin e dialogut Kosovë – Serbi;</p> |

| | | | |
|---|---|--|---|
| | | <p>majit të vitit 2014, EULEX ka transmetuar 855 kërkesa dhe përgjigje nga Kosova në Serbi, si dhe 756 kërkesa dhe përgjigje nga Serbia në Kosovë;</p> <p>5.3 (c) Këshilli Gjyqësor (KGJK) ka nënshkruar dy marrëveshje me Misionin e EULEX-it më 18 korrik dhe 12 gusht 2014, në funksion të zbatimit të ligjit për mandatin e ri të EULEX-it;</p> | |
| <p>5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar);</p> | <p>5.4. Hartimi dhe ndarja, në kohën e duhur, e statistikave të hollësishme për rastet e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale, me autoritetet kompetente të shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EULEX-it;</p> | <p>5.4 (a) Raportimi nga institucionet e zbatimit të ligjit të Kosovës bëhet përmes Dialogut për Procesin e Stabilizim-Asocimit (DPSA), Trupit Koordinues për Sundimin e Ligjit dhe raporteve për monitorimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave; Gjithashtu, siç është raportuar nga zyrtarët e EULEX-it, ndarja e informacionit bëhet në ekipe të përziera dhe në përputhje me Protokollet e Informacionit; Për më tepër, shkëmbimi i të dhënave është bërë edhe në forumet e organizuara nga institucionet e Kosovës, ku EULEX-i dhe organizatat ndërkombëtare janë ftuar të marrin pjesë;</p> | |
| <p>5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të</p> | <p>5. 5. Kosova duhet të shqyrtojë modalitetet e bashkëpunimit me EUROJUST dhe të konsiderojë ratifikimin e të gjitha konventave</p> | <p>5.5 (a) Kosova ka kërkuar bashkëpunim më të ngushtë me EUROJUST, megjithatë ajo përballet me vështirësi sepse nuk është anëtare;</p> | <p>5.5 (b) Ministria e Drejtësisë duhet të inicojë</p> |

| | | | |
|---|--|--|--|
| <p>organizuar);</p> | <p>përkatëse të Këshillit të Evropës, në fushën e ndihmës së ndërsjellë juridike;</p> | <p>5.5 (b) Pasi që Kosova nuk është shtet anëtar i EUROPOL-it dhe EUROJUST-it, Kosova bashkëpunon me ta përmes disa projekteve që këto agjenci kanë në Ballkanin Perëndimor;</p> | <p>ratifikimin e të gjitha konventave të Këshillit të Evropës në fushën e ndihmës së ndërsjellë juridike, së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme;</p> |
| <p>5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar);</p> | <p>5. 6. Kosova duhet të garantojë pavarësinë e sistemit gjyqësor; Për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit, një shumicë e konsiderueshme e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor duhet të zgjidhen nga kolegët e tyre;</p> | <p>5.6 (a) Pakoja e gjashtë ligjeve kryesore që kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2013 (Ligji për gjykatat, Prokurorinë e Shtetit, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, si dhe Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale) solli ndryshime të rëndësishme dhe reformat të thella në sistemin e drejtësisë në Kosovë, si rrjedhim gjithashtu edhe kompletimin e infrastrukturës ligjore në fushën e të drejtësisë penale dhe shmangien e zbrazëtirave ligjore dhe mangësive;</p> <p>5.6 (b) Për të shqyrtuar funksionalitetin e sistemit të drejtësisë penale (SDP), Ministria e Drejtësisë (MD), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), ka finalizuar draft-raportin paraprak për vlerësimin e funksionimit të drejtësisë penale të ristrukturuar. Draft-raporti përmbledh të metat me të cilat ballafaqohen agjencitë e</p> | <p>5.6 (a) Duhet përmirësuar më tej pavarësinë e gjyqësorit duke harmonizuar katër ligjet themelore, të cilat kanë hyrë në fuqi në janar të vitit 2013, lidhur me kriteret për emërimin ose shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjithashtu, Ligji për Gjykatat, për Prokurorin e Shtetit, Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial duhet të jenë të harmonizuara, për të adresuar mospërputhjet mbi çështje të tilla si shkarkimi, emërimi, transferimi, sistemi disiplinor, si dhe procedurat për rishikimin e vendimeve të marra nga këshillat;</p> <p>5. 6 (c) Një shumicë e konsiderueshme e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor duhet të</p> |

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>zbatimit të ligjit në lidhje me SDP dhe reformat e parashikuara, duke përfshirë një pasqyrë të plotë të zbatimit të këtyre reformave dhe të legjislacionit përkatës.</p> <p>5.6 (c) Mekanizmi llogaridhënës në raport me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) - Gjykatat dhe përbërjen e anëtarësisë së KGJK-së mbetet një sfidë, pasi që sipas standardeve evropiane, KGJK-së i është rekomanduar që shumica e gjyqtarëve nga përbërja e saj, të zgjedhet nga kolegët e tyre, ose të paktën jo më pak se 50% e anëtarëve të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga kolegët e tyre nga të gjitha nivelet e gjyqësorit, e cila në kthim, do të sigurojë pluralizmin brenda gjyqësorit;</p> <p>5.6 (d) Unifikimi i kriterëve për përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe të provimeve për gjyqtarë dhe prokurorë, si pjesë e kriterëve të përshtatshmërisë për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë, mbeten të varur me procesin e harmonizimit të katër ligjeve kryesore të sistemit gjyqësor: Ligji mbi Gjykatat , Ligji për Prokurorin e Shtetit, Ligji për Këshillin Gjyqësor dhe Ligji për Këshillin Prokurorial, ky i fundit aktualisht në proces;</p> | <p>zgjedhen nga kolegët e tyre; Ende duhet të emërohen dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor; Një shumicë e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor duhet të zgjedhet nga kolegët e tyre, në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias;</p> <p>5.6 (d) Duhet bërë harmonizimi i katër ligjeve themelore që kanë hyrë në fuqi në janar të vitit 2013 në lidhje me kriteret për emërimin apo shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve;</p> <p>5.6 (e) Kuvendi duhet të emërojë, urgjentisht, anëtarët e rinj të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), në mënyrë që KGJK-ja të funksionalizohet, për shkak të rolit thelbësor që ka në administrimin dhe menaxhimin e gjyqësorit të Kosovës;</p> |
|--|--|---|--|

| | | | |
|---|--|---|---|
| | | <p>5.6 (e) Një sfidë e vazhdueshme ka të bëjë me mos-funksionimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), për shkak të mungesës së kuorumit. Gjithashtu, pavarësia buxhetore dhe financiare e gjyqësorit në Kosovë dhe nevoja për miratimin e Ligjit për Administratën Gjyqësore mbetet një sfidë; Lidhur me pavarësinë e gjyqësorit, buxhetet për të dy këshillat mesatarisht janë rritur në krahasim me vitin e kaluar. Buxheti i Këshillit Gjyqësor për vitin 2014 është 20.8 milion Euro, kurse i Këshillit Prokurorial është 6.8 milion Eur;</p> | |
| <p>5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar);</p> | <p>5.7. Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial, duhet të sigurojnë që personat e nominuar për postin e gjyqtarit apo prokurorit kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe të plotësojnë kushtet e përcaktuara;</p> | <p>5.7 (a) Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës kanë përforcuar edhe më tej procesin e rekrutimit, emërimit dhe rrimërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe kriteret përkatëse të performancës dhe të vlerësimit duke plotësuar legjislacionin e nevojshëm ndihmës. Si rezultat i kriterëve të rrepta të vlerësimit dhe ri-emërimit, KGJK-ja nuk ka propozuar për ri-emërim një (1) gjyqtar tek Presidentja e Kosovës. Këto masa kontribuojnë ndjeshëm në cilësinë e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve;</p> <p>5.7 (b) Në mënyrë që të emërohen prokurorë më me përvojë në</p> | <p>5.7 (b) Burimet e prokurorisë vazhdojnë të jenë të mangëta sa i përket numrit të prokurorëve që kanë të bëjnë me rastet e korrupsionit, pra numri i tyre ende mbetet i ulët. Numri i prokurorëve në Prishtinë dhe në prokuroritë e tjera në nivel lokal duhet të rritet;</p> <p>5.7 (c) Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet ta ketë</p> |

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>Prokurorinë Speciale (PSRK), prokurorët e Prokurorive të tjera, sidomos nga Prishtina, janë transferuar për në PSRK;</p> <p>5.7 (c) Me rritjen e numrit të përgjithshëm të prokurorëve në 139-140, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka filluar specializimin e prokurorëve sipas llojit të veprës (prokurorët për luftën kundër korrupsionit, krimet të organizuar dhe kështu me radhë), që ka qenë në agjendë të KPK-së, që nga viti 2012. Trajnimet kanë filluar dhe pritet që struktura të zbatohet në praktikë deri më 2015-2016;</p> <p>5.7 (d) Më 3 korrik 2014, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka emëruar dy (2) gjyqtarë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. E gjithë kjo është bërë në kuadër të monitorimit të EULEX-it dhe do të vazhdojë të jetë i njëjtë edhe në proceset e rekrutimit në të ardhmen për të siguruar objektivitet në rekrutimin e gjyqtarëve të rinj. Lidhur me emërimin e gjyqtarëve nga komunitetet pakicë, me theks të veçantë mbi minoritetin serb, KGJK-ja ka pezulluar aktivitetet në këtë drejtim, në pritje të arritjes së marrëveshjes në mes të Kosovës dhe</p> | <p>prioritet specializimin e prokurorëve, sipas llojeve të veprave penale. Kjo gjë do të sigurojë luftë më të efektshme kundër krimeve të rënda;</p> <p>5.7 (d) Marrëveshja për drejtësi në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të arrihet sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që Këshilli Gjyqësor i Kosovës të jetë në gjendje të emërojë gjyqtarët e pakicës serbe;</p> |
|--|--|---|--|

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | Serbisë; | |
| 5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar); | 5.8. Rishikimi i sistemit të ri gjyqësor dhe prokurorial për të vlerësuar progresin; | 5.8 (a) Për të shqyrtuar funksionalitetin e sistemit të drejtësisë penale (SDP), Ministria e Drejtësisë (MD), Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), ka finalizuar draft-raportin paraprak për vlerësimin e funksionimit të drejtësisë penale të ristrukturuar. Draft-raporti përmbledh të metat me të cilat ballafaqohen agjencitë e zbatimit të ligjit në lidhje me SDP dhe reformat e parashikuara, duke përfshirë një pasqyrë të plotë të zbatimit të këtyre reformave dhe të legjislacionit përkatës; 5.8 (b) Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial kanë miratuar rregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e gjykatave dhe prokurorive. Gjithashtu Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka vazhduar të ofrojë trajnime të arsimit ligjor duke u fokusuar në ngritjen e kapaciteteve; | |
| 5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar); | 5. 9. Rregulloret disiplinore në të dy Këshillat duhet të rregullohen për të siguruar që procedurat disiplinore dhe politikat në luftën kundër korrupsionit në gjyqësor të çojnë në rezultate konkrete; | 5.9 (a) Të dy Këshillat (Gjyqësor dhe Prokurorial) kanë miratuar kodet e etikës. (KGJK, nr. 192/2012, Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; KPK, nr. 910/2012, Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Anëtarët e Këshillit | 5.9 (a) Për të përmirësuar nivelin e zbatimit, rregulloret disiplinore të të dy këshillave duhet të rregullohen për të siguruar që procedurat disiplinore dhe politikat në luftën kundër korrupsionit në gjyqësor të çojnë në rezultate konkrete; |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>Prokurorial të Kosovës);</p> <p>5.9 (b) Sa i përket efikasitetit të prokurorëve dhe matjes së performancës së tyre, një komision është themeluar në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) që të merret ekskluzivisht me matje të performancës;</p> <p>5.9 (c) Komisioni për vlerësimin e performancës, në kuadër të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), ka kryer një vlerësim të performancës së 24 prokurorëve me mandat fillestar (3 vjet), të cilat do të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme të Këshillit;</p> <p>5.9 (d) Në lidhje me strukturën e gjykatës, pas rezultateve të vitit 2013, në luftën kundër korrupsionit dhe vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK-së) në vitin 2012, për t'iu dhënë përparësi rasteve të korrupsionit, KGJK-ja miratoi një vendim shtesë për themelimin e komisionit për të mbikëqyrur punën e gjyqtarëve në rastet e korrupsionit;</p> <p>5.9 (e) Sa i përket funksionimit dhe llogaridhënies së gjyqësorit, Këshilli gjyqësor ka miratuar rregulloret për punën e komisionit disiplinor të saj, për promovimin e</p> | <p>5.9 (b) Për të rritur efikasitetin e prokurorëve duhet të bëhet rregullisht vlerësimi i performancës;</p> <p>5.9 (d) Duhet të kryhen rregullisht vlerësime të performancës së gjyqtarëve për rastet e korrupsionit dhe rastet e tjera;</p> <p>5.9 (e) Zbatimi i rregulloreve mbi performancën dhe vlerësimin, si dhe mbi procedurat disiplinore është i rëndësishëm, siç janë emërimi dhe përzgjedhja e kritereve në mënyrë transparente dhe të bazuara në merita;</p> |
|--|--|--|--|

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>gjyqtarëve, dhe për planin e saj strategjik 2014-19. Këshilli prokurorial ka miratuar edhe një rregullore për vlerësimin e performancës së prokurorëve;</p> <p>5.9 (f) Në bazë të "Rregullores për Vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve", Komiteti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve ka rekomanduar 75 gjyqtarë për rizgjedhje me mandat të përhershëm. Vetëm një gjyqtar nuk është e rekomanduar.</p> <p>5.9 (g) Në bazë të "Rregullores për Vlerësimin e Performancës së prokurorëve", të botuar në tetor të vitit 2013, Komisioni i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), në procesin e vlerësimit të performancës së prokurorëve vendosi që, në janar të vitit 2014, së pari të vlerësojë punën e 22 prokurorëve në mandatin e tyre të parë dhe pastaj punën e 35 prokurorëve të mandatit të tyre të përhershëm;</p> | |
| 5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në | 5. 10. Kosova duhet të adresojë ngarkesën me lëndë; | 5.10 (a) Edhe pse ka përparim në këtë drejtim, ende mbetet një ngarkesë e madhe me raste gjyqësore. Në gjysmën e | 5.10 (a) Kosova duhet të adresojë edhe më tej ngarkesën me lëndë, e cila është shtuar viteve të fundit. Për të rritur |

| | | | |
|--|--|---|---|
| <p>rastet e krimit të organizuar);</p> | | <p>parë të vitit 2014, në gjykata kanë qenë gjithsej 693.975 raste në proces, me 455.699 të trashëguara nga vitet e mëparshme. Gjatë kësaj periudhe gjykatat arritën që të përfundojnë vetëm 230,674 raste ose 33%;</p> <p>5.10 (b) Përveç kësaj, Ligji për procedurën përbarimore i miratuar në dhjetor të vitit 2012 dhe sistemi i ri i zgjidhjes alternative të konflikteve do të kontribuojnë në masë të madhe në zbatimin e vendimeve të gjykatave dhe zvogëlimin e ngarkesën me lëndë. Ministria e Drejtësisë (MD) ka miratuar legjislacionin e nevojshëm sekondar për emërimin e përbaruesve privatë. MD ka certifikuar edhe 14 përbarues privatë në tremujorin e parë të vitit 2014. Një numër i tyre janë caktuar edhe për nivelin lokal;</p> <p>5.10 (c) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka miratuar në gusht të vitit 2013, Strategjinë Kombëtare për zvogëlimin e lëndëve. Strategjia ofron një kuadër të përgjithshëm dhe lejon Gjykatat themelore të zhvillojnë planet e tyre individuale të veprimit për të trajtuar menaxhimin e rasteve duke marrë në konsideratë specifikat e çdo gjykate;</p> | <p>efektivitetin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor, buxheti i gjyqësorit duhet të merret në konsideratë. Gjithashtu, pavarësisht numrit të madh të rasteve të grumbulluara në gjykatat e Kosovës nuk ka pasur rritje të numrit të gjyqtarëve në 2014. Ngjashëm si në 2013 numri i gjyqtarëve për të gjitha gjykatat e Kosovës ishte 335, ndërsa numri i personelit mbështetës ishte në total 1437. Për këtë arsye numri i gjyqtarëve dhe stafit mbështetës duhet të rritet në përputhje me rrethanat; Duhet të bëhen përpjekje për të arritur një marrëveshje me Kompaninë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji elektrike (KEDS) dhe Postë Telekomin e Kosovës (PTK), për të tërhequr rastet e tyre dhe potencialisht transferimin e tyre tek përbaruesit privatë, në mënyrë që të nxjerret sistemi gjyqësor nga mbingarkesa;</p> <p>5.10 (b) Kosova duhet të sigurojë një mbikëqyrje adekuate të përbaruesve privatë. Duhet të rritet ndërgjegjësimi i publikut për ndërmjetësim dhe qendrat e ndërmjetësimit;</p> |
|--|--|---|---|

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>5.10 (d) Gjykatat nuk janë duke e zbatuar udhëzimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për priorizimin e rasteve të pazgjidhura. Në fund të vitit 2013, gjykatat kanë zgjidhur 419,422 raste, duke lënë 466,255 raste të pazgjidhura (një normë prej 80,3%). Zbatimi i strategjisë dy-vjeçare për të zvogëluar ngarkesën e rasteve të akumuluar deri në dhjetor 2008, ka rezultuar në një reduktim të rasteve prej rreth 65%. Në sistemin e tanishëm të regjistrimit të rasteve, është e mundur që i njëjti rast të llogaritet disa herë;</p> <p>5.10 (e) Për nivelin lokal (Rajoni i Pejës dhe komuna e Gjakovës) raportohet se gjyqtarët i kanë prioritet rastet e natyrës penale. Përveç kësaj, është hartuar një plan veprimi që parasheh që çdo gjyqtar duhet të kryejë 90% të lëndëve deri në fund të vitit. Shumica e lëndëve në fushën e korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë përfunduar;</p> <p>5.10 (i) Gjatë periudhës gjashtë mujore janar-qershor të vitit 2014, nga gjithsej raste të trajtuara nga prokurorët e Kosovës kundër 556 personave, prokurorët paditën më pak se gjysmën e rasteve d.m.th 248 persona ose 45% nga gjithsej 556 raste. Më shumë se gjysma e rasteve ose u shkarkuan</p> | <p>5.10 (c) Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ende ka nevojë për zhvillimin e treguesve të thjeshtë të performancës për të matur progresin e gjykatave themelore. Këto duhet të përmbahen në një sistem të unifikuar të raportimit që do ta lejojë KGJK-në që të mbledhë dhe analizojë informatat nga gjykatat themelore;</p> <p>5.10 (d) Për të zvogëluar ngarkesën me lëndë, është e domosdoshme themelimi i një baze të duhur të të dhënave, në mënyrë që e njëjta çështje të mos numërohet disa herë. Gjithashtu, duhet të kryhen trajnime mbi luftimin e krimeve ekonomike për zyrtarët ligjor të nivelit lokal;</p> |
|--|--|--|--|

| | | | |
|---|--|---|---|
| | | <p>ose u mbyllën nga hetime të mëtejshme me 308 persona ose 55% të rasteve të pushuara. Prokurorët ishin në gjendje për të hapur/procesuar vetëm 61% të këtyre rasteve, ndërsa gjykatat kanë qenë në gjendje për të dënuar vetëm 33% të rasteve të akuzuara. Kjo tregon mosefektivitet të gjykatave për të reaguar në kohë ndaj aktakuzave të ngritura si dhe ngre mëturje shqetësim për kapacitetet e gjykatave për të trajtuar këto raste;</p> <p>5.10 (j) Gjatë periudhës gjashtë mujore janar-qershor të vitit 2014, gjithsej 48 persona morën vendime gjyqësore lidhur me paditë e tyre për korrupsion. Nga ky numër vetëm 34 persona u gjetën fajtorë, ndërsa 5 persona u liruan nga të gjitha akuzat. Janë 200 persona ende në pritje për t'u konfirmuar aktakuzat e tyre nga gjykatat;</p> | |
| <p>5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar);</p> | <p>5.11. Autoritetet e Kosovës duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë qasjes në drejtësi për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, grave dhe fëmijëve;</p> | <p>5.11 (a) Në korrik të vitit 2013, u miratua Ligji për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve dhe Mbrojtjen e Viktimave të Njeriut. Koordinatori Kombëtar Kundër Trafikimit po bashkëpunon me autoritetet përkatëse dhe shoqërinë civile. Është hartuar një ligj për kompensimin e viktimave të krimit;</p> | <p>5.11 (a) Autoritetet e Kosovës duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë qasjes në drejtësi për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore; Duhet të miratohet Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit;</p> <p>5.11 (b) Kosova duhet të miratojë Strategjinë e re për Luftimin e Trafikimit të</p> |

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | <p>5.11 (b) Strategjia e re për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Planit të Veprimit 2014-2019, është përfunduar nga grupi i punës dhe i është dërguar Qeverisë për miratim;</p> <p>5.11 (c) Me qëllim të plotësimit të kuadrit ligjor, si dhe implementimin dhe zbatimin për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, Udhëzimi Administrativ për licencimin e OJQ-ve u miratua në Dhjetor 2013, që rregullon licencimin e OJQ-ve për strehimin e viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe viktimat e dhunës në familje. Edhe pse, Kosova kishte Ligjin për Familjen dhe Shërbimet sociale që nga viti 2005, i cili ka parashikuar rolin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të licencojë OJQ-të që ofrojnë shërbime për viktimat, megjithatë, legjislati nuk është zbatuar. Gjithashtu, korniza legjislative lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, armëve dhe drogës ka përfunduar;</p> <p>5.11 (d) Institucionet e Kosovës kanë bërë progres në drejtim të përmirësimit të kushteve për rehabilitimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore (TQNJ). Në këtë drejtim, Ministria e Punës dhe Mirëqenies</p> | <p>Qenieve Njerëzore dhe Planin e Veprimit 2014-19;</p> <p>5.11 (c) Kosova duhet të fokusohet në zbatimin e Ligjit për Parandalimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, veçanërisht në lidhje me kompensimin e viktimave dhe financimin e qëndrueshëm të strehimoreve. Një qasje gjithëpërfshirëse, multi-disiplinore dhe e orientuar nga viktimat e trafikimit duhet të zhvillohet, si dhe identifikimi i viktimave ka nevojë të përmirësohet më tej;</p> <p>5.11 (d) Sipas nevojës, duhet të kryhen trajnime të tjera; Palët e tjera të interesuara të tilla si: policia kufitare, inspektorët dhe prokurorët e punës duhet të jenë të trajnuar në procedurat standarde ekzistuese operative, si dhe gjithashtu të rrisin kapacitetet e tyre për të identifikuar dhe për të ndihmuar fëmijët lëmshëtarë që janë viktimat e trafikimit;</p> |
|--|--|---|---|

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>Sociale (MPMS) menaxhon një Strehimore Speciale të Përkohshme, e cila ka bazën në Lipjan dhe e cila ofron strehim dhe rehabilitim për të gjitha viktimat. Për më shumë, prej shtatorit të vitit 2012 deri në mars 2013, Policia e Kosovës (PK) ka identifikuar 13 viktima të TQNJ dhe 4 viktimat të mundshme të TQNJ-së, ndërsa 11 viktimave u është ofruar strehim në Strehimoren Speciale të Përkohshme në kuadër të MPMS. Gjithashtu, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është angazhuar në 2 raste të trafikimit të qenieve njerëzore, ku janë identifikuar 3 viktima;</p> <p>5.11 (e) Në kushtet e sigurimit të mbështetjes për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore (TQNJ), objekti i Sigurisë së Përkohshme (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - MPMS), gjatë periudhës raportuese ka strehuar gjashtë (6) Viktima te Trafikimit. Procesi i licencimit të shërbimeve sociale dhe familjare ka vazhduar, dhe deri tani 284 aplikacione janë pranuar nga sektori si qeveritar dhe nga ai jo-qeveritar dhe 225 ofruesit e shërbimeve të tilla janë licencuar, ndërsa 39 janë duke u përpunuar. Gjatë periudhës raportuese, 53 zyrtarë (individë) në nivel themelor dhe 25 në nivel të mesëm janë licencuar</p> | <p>5.11 (e) Autoritetet e Kosovës duhet të rrisin përpjekjet për të përmirësuar qasjen në drejtësi për fëmijët, gratë dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore;</p> <p>5.11 (f) Qeveria duhet të hartojë dhe të zhvillojë plane në mënyrë që të sigurojë se ndihma juridike është ofruar, dhe se zyrat e mbyllura nuk do të mohojnë të drejtën e personave dhe të viktimave për ndihmë juridike dhe qasje të lirë në drejtësi;</p> |
|--|--|---|--|

| | | | |
|---|--|--|---|
| | | <p>nga Këshilli i Përgjithshëm (MPMS) për shërbime sociale dhe familjare në ofrimin e shërbimeve të tilla;</p> <p>5.11 (f) Njësia e asistencës dhe e avokimit për viktimat (VAAU), prej 1 majit deri me 31 korrik 2014, ka ofruar ndihmë juridike për 13 viktima të trafikimit (VT). Avokatët e viktimave kanë ofruar ndihmë në lidhje me informimin e VT-ve mbi të drejtat e tyre, legjislacionin në fuqi, ndihmë e përgjithshme juridike dhe të gjitha procedurat ligjore;</p> <p>5.11 (g) Prej 1 majit deri me 31 korrik 2014, tetë (8) fëmijë (viktima të mundshme të trafikimit) kanë përfituar shërbime nga Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët (SDSF) në lidhje me standardet minimale të kujdesit për viktimat e trafikimit (VT). Një (1) i mitur është ndihmuar dhe do të vazhdojë arsimin e rregullt.</p> | |
| <p>5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar);</p> | <p>5.12. Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial duhet t'u përgjigjen me vendosmëri sulmeve ndaj individëve dhe institucioneve gjyqësore. Institucionet e tjera të qeverisë duhet të bëjnë të njëjtën gjë;</p> | <p>5.12 (a) Bezdisjet nga ana e mediave ndaj gjykatësve dhe prokurorëve, dhe mungesa e një përgjigje efektive nga ana e institucioneve përkatëse vazhdojnë të jenë një shqetësim serioz;</p> <p>5.12 (b) Asnjë rast i presionit apo ndërhyrjes ndaj punës së prokurorëve apo gjyqtarëve nuk është</p> | <p>5.12 (a) Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës duhet të dalin me deklarata që dënojnë çdo sulm ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve;</p> <p>5.12 (b) Pavarësisht asaj asnjë rast i presionit apo ndërhyrjes ndaj punës së prokurorëve dhe gjyqtarëve nuk është raportuar deri më tani,</p> |

| | | | |
|---|---|--|--|
| | | <p>raportuar deri më tani. Pavarësisht kësaj, zyrtarët e EULEX-it kanë deklaruar disa herë se prokurorët vendorë mund të jenë nën presion, duke u bazuar në refuzimin e tyre për t'u marrë me një çështje të caktuar. Nga ana tjetër, Këshilli Prokurorial i Kosovës vazhdon të deklarojë se ka pasur vetëm një rast në 5 vjet, që një prokuror vendor ka refuzuar marrjen e një rasti, dhe kjo për shkak të konfliktit të interesit;</p> | <p>për të shmangur çdo ndërhyrje të mundshme, sidomos në rastet e profilit të lartë të trajtuara nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), kjo Prokurori duhet të ketë policinë e vet gjyqësore;</p> <p>5.13 (c) Përpjekjet për të ndikuar në hetimet në vazhdim dhe rastet gjyqësore duhet të sanksionohen në mënyrë efektive. Kjo duhet të mbështetet fuqimisht nga vullneti politik;</p> |
| <p>5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar);</p> | <p>5.13. Nevojat për siguri të personelit gjyqësor, dëshmitarëve dhe paditësve duhet të adresohen. Kosova ka nevojë për të siguruar zbatimin efikas të legjislacionit;</p> | <p>5.13 (a) Tani, mbrojtja e prokurorëve është duke u dhënë sipas kërkesave individuale të prokurorëve të Policisë së Kosovës dhe vlerësimit të faktorëve të rrezikut nga ana e policisë. Aktualisht, në Prokurorinë Speciale (PSRK), nuk ka asnjë prokuror i cili është nën mbikqyrje. Gjithashtu, vlerësimi i rrezikut për personelin gjyqësor bëhet nga Policia e Kosovës;</p> <p>5.13 (b) Frikësimi i dëshmitarëve dhe mbrojtja e tyre vazhdon të jetë një shqetësim serioz edhe pse Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është miratuar. Në mënyrë që të garantohet zbatimi i marrëveshjes dhe mandatit të ri të EULEX-it, Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve</p> | <p>5.13 (a) Përveç ofrimit të mbrojtjes për prokurorët, masat e sigurisë duhet të sigurohen gjithashtu edhe për mbrojtjen e familjeve të tyre, varësisht nga rëndësia dhe vlerësimi i rastit;</p> |

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | <p>është ndryshuar. Gjithashtu, janë miratuar një sërë aktesh ligjore të legjislacionit dytësor;</p> <p>5.13 (c) Në mënyrë që të rrisin më tej bashkëpunimin ndër-institucional për mbrojtjen e dëshmitarëve, dy marrëveshje janë përfunduar në tremujorin e parë të vitit 2014: një në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), nënshkruar më 6 shkurt 2014, si dhe një mes MPB-së dhe EULEX-it, nënshkruar më 11 mars 2014;</p> <p>5.13 (d) Është miratuar zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi në mes të policisë dhe EULEX-it. Në mënyrë që të vazhdohet me zbatimin e legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, në qershor të vitit 2014, është nënshkruar një dokument mbi Procedurën Standarde të Operimit (PSO) për përfundimin e programit të paraparë me ligj për mbrojtjen e dëshmitarëve;</p> <p>5.13 (e) Sipas zyrtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe zyrtarëve të EULEX-it, ende ka raste të dëshmitarëve që</p> | <p>5.13 (f) Kosova duhet të nënshkruajë marrëveshje për zhvendosjen e dëshmitarëve në mënyrë që të sigurohet funksionimi i sistemit gjyqësor dhe pa pengim i drejtësisë;</p> <p>5.13 (g) Departamentit për mbrojtjen e dëshmitarëve (DMD) i mungojnë burimet e nevojshme për të përmbushur në mënyrë efektive mandatin e saj. Qeveria duhet të sigurojë që DMD-ja ka të gjitha burimet e nevojshme për të kryer detyrat e veta;</p> |
|--|--|---|---|

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>ngurrojnë të dëshmojnë, kryesisht për shkak të frikës së hakmarrjes nga ana e të pandehurit;</p> <p>5.13 (f) Katër gjykata themelore si dhe gjykata e apelit janë pajisur me dhoma të veçanta për dëshmitarët e mbrojtur. Drejtoria e Mbrojtjes së Dëshmitarëve është formuar në kuadër të Policisë së Kosovës (PK), dhe ka trajnuar personelin për mbrojtjen e dëshmitarëve. Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, konkretisht neni 28, i jep PK-së të drejtën për të bashkëpunuar me shtetet e tjera për zhvendosjen e dëshmitarëve. Për shkak të madhësisë së territorit të Republikës së Kosovës, në rastet me rrezik më të lartë sipas vlerësimeve të PK-së, dëshmitarët duhet të rialokohen. PK-ja ka miratuar të gjitha aktet nënligjore që burojnë nga ligji, si dhe, gjithashtu, ka nënshkruar marrëveshje me ministri të ndryshme të Kosovës për të mbrojtur dëshmitarët;</p> <p>5.13 (g) Deri më tani, Policia e Kosovës ka punësuar 13 anëtarë të stafit të trajnuar në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve (DMD). Drejtoria e e PK-së iu ka dhënë automjetet e tyre DMD-së, si dhe automjete të tjera priten nga Mbrojtja e dëshmitarëve në Luftën kundër Krimeve</p> | |
|--|--|--|--|

| | | | |
|---|---|---|--|
| | | <p>të Rënda dhe Terrorizmit (WINPRO). Janë arritur marrëveshje të përgjithshme për bashkëpunim dhe mbrojtjen e dëshmitarëve me disa vende evropiane;</p> <p>5.13 (h) Me qëllim të rritjes së kapaciteteve në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve, gjatë periudhës raportuese, 8 trajnime janë kryer për 33 pjesëmarrës, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e dëshmitarëve. Zyrtarët e mbrojtjes së dëshmitarëve gjithashtu kanë marrë pjesë në një trajnim të avancuar për bashkëpunim ndërkombëtar të organizuar në Holandë, e cila gjithashtu rezultoi me anëtarësimin e Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (DMD) në programin e ekspertëve të EUROPOL-it për mbrojtjen dëshmitarëve;</p> | |
| <p>5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar);</p> | <p>5.14. Puna e Prokurorisë Speciale duhet të përforcohet duke rekrutuar prokurorë të rinj, në mënyrë që të merren me rastet e ndjeshme dhe ato të nivelit të lartë, d.m.th duhet rritur numrin e prokurorëve;</p> | <p>5.14 (a) Aktualisht, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka 12 prokurorë vendorë. Vitin e kaluar 5 prokurorë janë shtuar. Pas një kërkesë për rritjen e numrit të prokurorëve, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka miratuar edhe 3 prokurorë më shumë, një i rezervuar për komunitetet. Numri i tanishëm i prokurorëve është ende i pamjaftueshëm dhe qëllimi i PSRK-së është që të rritet numri i</p> | <p>5.14 (a) Numri i prokurorëve në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) duhet të rritet sipas kërkesës. Qeveria e Kosovës duhet të dyfishojë fondet për PSRK-në në 1,120,000.00 Eur (tani ka 593,000.00 €), duke u bazuar në modelin e Kroacisë, të përdorimit të 0,62 € për kokë banori për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kosova aktualisht ndan vetëm 0,32 € për kokë banori për</p> |

| | | | |
|--|--|---|--|
| | | <p>prokurorëve në 25;</p> <p>5.14 (b) Në mënyrë që të rritet efektiviteti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), në mesin e objektivave të PSRK-së është ndarja e PSRK-së në departamente (krimi i organizuar, korrupsioni, krimet e luftës) dhe specializimi i të paktën tre (3) prokurorëve në krime luftime. Strukturimi i tillë është aktualisht i vështirë për shkak të numrit të pamjaftueshëm të prokurorëve;</p> <p>5.14 (c) Prokurorët special të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (SPRK) kanë normën më të ulët të efektivitetit me normë prej 68 raste ose 89% të gjithsej 76 rasteve, të cilat janë hedhur poshtë/mbyllur ose ndërprerë nga hetime të mëtejshme, në gjysmën e parë të vitit 2014. Në nivel rajonal, prokuroria themelore në Pejë hodhi poshtë / mbylli dhe ndërpreu hetimet e mëtejshme për 47 raste ose 72% nga gjithsej 65 raste të korrupsionit, ndërsa prokuroria themelore në Gjakovë hodhi poshtë / mbylli dhe ndërpreu hetimet e mëtejshme për 19 raste apo 53 % nga gjithsej 36 raste;</p> | <p>të arritur këtë qëllim;</p> <p>5.14 (b) Duhet të ndryshohet ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), në mënyrë që të parashikohet themelimi i një policie gjyqësore që do të rrisë më tej efektivitetin e PSRK-së; Për më tepër, numri i prokurorëve duhet të rritet, në mënyrë që të rritet efikasiteti i PSRK-së;</p> |
| 5) Sistemi gjyqësor (Bashkëpunimi i | 5.15. Kosova duhet të zhvillojë një sistem të | 5.15 (a) As alokimi i rasteve e as sistemi i | 5.15 (a) Duhet të ndërmerren të gjitha |

| | | | |
|---|--|---|---|
| <p>sistemit gjyqësor në çështjet penale duke u fokusuar në rastet e krimit të organizuar);</p> | <p>regjistrimit të informimit penal; Duhet rregulluar në mënyrë të përshtatshme menaxhimi i tij;</p> | <p>Teknologjisë së Informacionit (TI) për menaxhimin e çështjeve nuk ekzistojnë, si dhe nuk ka asnjë bazë të dhënash të centralizuar për regjistrimin e rasteve penale, gjë që po e pengon efikasitetin e sistemit gjyqësor. Një Memorandum Mirëkuptimi është nënshkruar më 5 shtator nga Ministri i Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, si dhe ambasadori i Norvegjisë. Norvegjia do të dhurojë 6 660 00,00 € , për një periudhë 4 vjeçare për zbatimin e këtij projekti, i cili është pjesë e Strategjisë së TIK-ut (2012 - 2017) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit dhe Lëndëve (SMIL) synon të përmirësojë efikasitetin, përgjegjësinë dhe transparencën e shërbimeve të gjyqësorit dhe Prokurorisë;</p> <p>5.15 (b) Në nivelin e bashkëpunimit institucional, që synon harmonizimin e statistikave, mekanizmi përcjellës i integruar për hetimin dhe ndjekjen penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit është plotësisht funksional. Mekanizmi përcjellës është zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me EULEX-in dhe Zyrën e</p> | <p>masat e nevojshme për të zbatuar projektin TIK-bazuar në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit dhe Lëndëve (SMIL) me sukses;</p> <p>Zbatimi i suksesshëm i SMIL-it do të sigurojë alokimin dhe menaxhimin e duhur të rasteve dhe do të zvogëlojë rrezikun për shumëzimin e rasteve, duke ndihmuar kështu në uljen e rasteve ekzistuese të grumbulluara;</p> <p>5.15 (c) Të kryhen trajnime edhe për nivelin lokal, në mënyrë për t'i pajisur ata me kompetencën e nevojshme për të përdorur sistemin e bazës së të dhënave në kuadër të projektit TIK-bazuar në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit dhe Lëndëve (SMIL);</p> |
|---|--|---|---|

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>BE-së në Kosovë. Mekanizmi përcjellës ofron statistika të harmonizuara duke filluar 2013 e tutje;</p> <p>5.15 (c) Unifikimi i të dhënave nëpër institucionet e sundimit të ligjit mbetet një sfidë. Disa trajnime janë paraparë për zyrtarët e sundimit të ligjit, në mënyrë për t'i pajisur ata me kompetencat e nevojshme për të përdorur sistemin e bazës së të dhënave në kuadër të projektit TIK-bazuar Sistemin e Menaxhimit të Informacionit dhe Lëndëve (SMIL), projekt ky i financuar nga Ministria Norvegjeze dhe Punëve të Jashtme;</p> | |
|--|--|--|--|

VI. Luftimi i Pastrimit të Parave

| Fusha | Veprimet që duhet të ndërmerren (Treguesit) | Çfarë është bërë deri më tani? Treguesit janë marrë nga raportet e progresit të BE-së dhe Udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave për Kosovë, dhe nga monitorimi ynë në kuadër të këtij projekti | Rekomandimet |
|--|---|--|--|
| 6) Luftimi i pastrimit të parave; | 6.1. Kosova duhet të zbatojë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; | <p>6.1 (a) Në janar të vitit 2014, Qeveria ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;</p> <p>6.1 (b) Në fund të muajit prill të vitit 2014, është botuar raporti i parë mbi Strategjinë për Parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar;</p> <p>6.1 (c) Njësia për Intelgjencë Financiare (NJIF), në mënyrë që të kryejë plotësisht funksionet e saj, ka planifikuar rritjen e personelit. Numri i raporteve të transaksioneve të dyshimta mbetet i lartë; por ende nuk është raportuar për dënime. Gjatë periudhës 2014-2015, janë dhënë dy (2) aktgjykime në lidhje me pastrimin e parave. Në një rast në Mitrovicë, të pandehurit u liruan kurse në rastin tjetër në Gjykatën Themelore të Prishtinës, të pandehurit u shpallën fajtorë dhe u dënuan për këtë krim;</p> | <p>6.1 (a) Duke pasur parasysh rezultatet e dobëta të arritura deri më tani në lidhje me parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, zbatimi i strategjisë dhe planit të ri të veprimit dhe shqyrtimi i saj, sipas nevojës, duhet të adresohet në mënyrë që të prodhohen rezultatet e dëshiruara;</p> <p>6.1 (c) Kosova ka vazhduar të ketë një shkallë të ulët të dënimeve për rastet e pastrimit të parave. Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi kanë mbetur dobët të zbatuara. Strukturat gjyqësore dhe prokuroriale të Kosovës duhet të analizojnë dhe vlerësojnë tërësisht mangësitë në trajtimin e rasteve të pastrimit të parave. EULEX-i me mandatin e tij të ri duhet të ndërtojë kapacitetet e institucioneve të Kosovës për të zbatuar plotësisht këtë rekomandim;</p> |
| 6) Luftimi i pastrimit të | 6.2. Monitorimi i punës së Njesisë për Intelgjencë | 6.2 (a) Ligji i rishikuar zgjeron dhe forcon mandatin e Njesisë për | 6.2 (b) Është thelbësor që të krijohet një histori e të dhënave |

| | | | |
|-----------------------|--|--|--|
| <p>parave;</p> | <p>Financiare, bashkëpunimit dhe kapaciteteve, duke përfshirë, por jo kufizuar në, monitorimin e emërimit të zyrtarit ndërlidhës së policisë; monitorimin e detyrimeve financiare të subjekteve raportuese; dhe inspektimeve të përbashkëta me Bankën Qendrore të Kosovës;</p> | <p>Intelegjencë Financiare (NJIF); NJIF shihet si një mjet i rëndësishëm, mandati dhe funksionet e së cilës, të caktuara me ligj, janë raportuar të jenë në përputhje me Rekomandimin Nr. 29 të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF);</p> <p>6.2 (b) Memorandumi i Mirëkuptimit (MM) në mes të Policisë së Kosovës (PK) dhe Njesisë për Intelegjencë Financiare (NJIF) për shkëmbimin elektronik të informacionit, i nënshkruar në shkurt të vitit 2013, është zbatuar plotësisht nga të dyja palët. Gjithashtu, zyrtarë të lartë të NJIF, kanë deklaruar se bashkëpunimi mes PK-së dhe NJIF-it është i mirë;</p> <p>6.2 (c) Policia e Kosovës ende duhet të emërojë një zyrtar ndërlidhës të policisë brenda Njesisë për Intelegjencë Financiare (NJIF); Njësia për Intelegjencë Financiare (NJIF) ka emëruar zyrtarë ndërlidhës në doganat e Kosovës dhe administratën tatimore, për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin operacional midis zyrave. Në fillim të vitit 2015, një zyrtar ndërlidhës nga Policia e Kosovës (PK), u caktua në NJIF.</p> <p>6.2 (d) Bashkëpunimi ndërmjet Njesisë për Intelegjencë Financiare (NJIF) dhe doganave është në nivel të kënaqshëm;</p> <p>6.2 (e) Njësia për Intelegjencë Financiare (NJIF) ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me</p> | <p>për vendimet e formës së prerë të gjykatës, në rastet që kanë të bëjnë pastrimin e parave; Këto shënime për vendimet e formës së prerë duhet të tregojnë përmirësimet, regresin si dhe duhet të nxjerrin në pah të metat e sistemit, në mënyrë që të përcjelllet sukcesi dhe dështimet e gjykatave në luftimin e rasteve të pastrimit të parave.</p> <p>6.2 (c) Njësia për Intelegjencë Financiare dhe Policia e Kosovës (PK) kanë deklaruar se kanë bashkëpunim të mirë. Emërimi i zyrtarit ndërlidhës nga PK, ka përmirësuar tutje këtë bashkëpunim; Megjithatë, një zyrtar ndërlidhës i policisë duhet të emërohet, në mënyrë që ky bashkëpunim të përmirësohet më tej;</p> <p>6.2 (e) Bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet institucioneve përkatëse të sektorit publik në lidhje me pastrimin e parave duhet të standardizohet. Përveç kësaj, vetëdija dhe pjesëmarrja nga</p> |
|-----------------------|--|--|--|

| | | | |
|--|--|---|---|
| | | <p>departamentin e regjistrimit OJQ-ve në Ministrinë e Administratës Publike, për të mundësuar monitorimin më të mirë të detyrimeve financiare të subjekteve raportuese;</p> <p>6.2 (f) Njësia për Intelegjencë Financiare (NJIF) ka forcuar marrëdhëniet e saj me bankat në Kosovë. NJIF ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Bankën Qendrore të Kosovës, për të mundësuar inspektime të përbashkëta. Më tej, analiza të këtij bashkëpunimi në zbatim duhet të analizohen;</p> <p>6.2 (g) Në vitin 2011, Njesisë për Intelegjencë Financiare (NJIF) iu hoq kompetenca për inspektime dhe dhënien e gjobave ndaj bankave, kështu që bankat nuk kanë raportuar. Në vitin 2013, me ndryshimet e ligjit, këto kompetenca janë kthyer sërish në mandatin e NJIF-it në mënyrë që bankat të fillojnë raportimin përsëri. Sipas ndryshimeve të paraqitura në ligjin e ri, NJIF mund të kryejë inspektime me nismën e vet, të vendosë dënime dhe të përgatisë një vlerësim kombëtar të rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;</p> <p>6.2 (h) Bazuar në kornizën e shpenzimeve afatmesme, Njësia për Intelegjencë Financiare (NJIF), për të kryer plotësisht detyrat shtesë të parashikuara nga ligji i ndryshuar, ka planifikuar rritjen e personelit të saj. 20 pozita të stafit janë miratuar, por buxheti për dy (2) anëtarë të stafit nuk është ndarë qe 2 vjet; Aktualisht, stafi i NJIF-it përbëhet nga 18 zyrtarë, tre (3) prej tyre janë të EULEX-it, të cilët kryesisht monitorojnë</p> | <p>sektori privat dhe i tretë duhet të rritet;</p> <p>6.2 (h) Sipas raportit të PECK-ut, Njësia për Intelegjencë Financiare (NJIF) ka kapacitete të pamjaftueshme institucionale, e cila reflektohet në kapacitetet e saj për të rritur bashkëpunimin me autoritetet e tjera vendore, qasjen në informata dhe për të përmirësuar cilësinë e analizave. Për të rritur më tej kapacitetet e NJIF-së, burimet njerëzore shtesë të kërkuara në dokumentin strategjik "Performanca dhe Plani i Burimeve të Njesisë për Intelegjencë Financiare të Kosovës 2015-2017", duhet të ndahen sa më shpejt që të jetë e mundur;</p> |
|--|--|---|---|

| | | | |
|---|--|--|--|
| | | <p>punën e NJIF-it; Nevojat e NJIF-së për personelin e ri janë paraqitur në dokumentin strategjik të saj "Performanca dhe Plani i Burimeve të Njesisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës 2015-2017", me të cilin është planifikuar rritja e personelit me gjashtë (6) zyrtarë deri më 31.12.2017. Burime njerëzore shtesë do të ndahen në funksion të Mbikëqyrjes së Përputhshmërisë (3), Operacioneve dhe Analizave (2) si dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar Ligjor (1).</p> | |
| <p>6) Luftimi i pastrimit të parave;</p> | <p>6.3. Zbatimi i legjislacionit dhe procedurave standarde të punës është i nevojshëm për të përmirësuar zbatimin e Ligjit të ri për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me fokus në pastrimin e parave;</p> | <p>6.3 (a) Kuvendi ka miratuar një ligj për konfiskimin e aseteve, dhe ka rishikuar ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;</p> <p>6.3 (b) Dy kurse trajnimi janë mbajtur për punonjësit e Njesisë për Inteligjencë Financiare (NJIF), se si të përdorin siç duhet Procedurën e re Standarde Operative (PSO) të Mbikëqyrjes së Pajtushmërisë (14.01.2014) dhe për inspektimet efektive të pajtushmërisë. Dy kurse të tjera trajnimi u organizuan për PSO-në e Mbikëqyrjes së Pajtushmërisë; tri trajnime për sistemin goAML (aplikimi elektronik për analizat e NJIF-it); një trajnim për Kodin e ndryshuar të Procedurës Penale të Kosovës; një trajnim për legjislacionin e Kosovës, që është i</p> | <p>6.3 (a) Në përgjithësi, ka pasur mungesë të vullnetit nga ana e institucioneve të Kosovës për të zbatuar plotësisht kuadrin ligjor dhe strategjik në lidhje me pastrimin e parave. Ky vullnet është ndërprerë shpesh nga ndërhyrjet politike, kapacitetet e stafit dhe emërimet politike, të cilat kanë rrezikuar integritetin e institucioneve të mandatuara për të luftuar e pastrimin e parave.</p> <p>Zbatimi i plotë i ligjeve dhe politikave, që garantojnë integritetin e institucioneve, do të rrisin edhe zbatimin e ligjit të ri për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;</p> <p>6.3 (b) Sipas nevojës, duhet të organizohen trajnime shtesë për personelin e Njesisë për Inteligjencë Financiare (NJIF);</p> <p>6.3 (c) Projektligji i ri për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit duhet të miratohet sa më shpejt që të jetë e mundur në mënyrë që të përshpejtohet anëtarësimi i</p> |

| | | | |
|---|--|--|---|
| | | <p>rëndësishëm për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit; dhe një seminar mbi konfiskimin e aseteve. Pavarësisht rëndësisë së trajnimeve adekuate për zyrtarët e NJIF-it, menaxhmenti i njësisë mbetet i vetëdijshëm për rrezikun që stafi tashmë i specializuar do të kërkojë punë më fitimprurëse, për shembull në sektorin bankar;</p> <p>6.3 (c) Korniza ligjore për Pastrimin e parave është zgjeruar më tej me miratimin e dokumenteve të mëposhtme me datën 15 korrik 2014: Manual Standard Operativ (MSO) për goAML bazuar në proceset e punës; MSO lidhur me kërkesat automatike të informacionit nga Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF) në Policinë e Kosovës; MSO në shkëmbimin e informacionit ndërmjet NJIF-it dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK); Manuali i përdoruesit për Format goAML; dhe Manuali Web goAML për subjektet raportuese përdoruesit. Gjithashtu, qeveria ka miratuar dy Direktiva Administrative (DA) dhe gjashtë Udhëzime Administrative (UA) që janë të lidhura drejtpërdrejtë me luftën kundër pastrimit të parave. Për më tepër, një Projektligji i ri për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit është në fazën e finalizimit;</p> | <p>Njësisë për Inteligjencë Financiare të Kosovës në Grupin Egmont;</p> |
| <p>6) Luftimi i pastrimit të parave;</p> | <p>6.4. Duhet të forcohen kapacitetet analitike dhe hulumtuese të Njësisë për Inteligjencë Financiare (NJIF);</p> | <p>6.4 (a) Ligji i rishikuar zgjeron dhe forcon mandatin e Njësisë për Inteligjencë Financiare (NJIF);</p> <p>6.4 (b) Në lidhje me zbatimin në këtë fushë, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2014, Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF) ka</p> | <p>6.4 (b) Nuk ka statistika mbi llogaritjen e shkaktimit të dëmit të përgjithshëm për rastet e hetuara në lidhje me</p> |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>pranuar 72 raportime për transaksione të dyshimta (STR), numër që tregon rritje prej 67% të transaksioneve të dyshimta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Prej 39 rasteve, Prokuroritë, gjatë periudhës janar-qershor 2014, kanë zgjidhur 6 raste që përfshijnë 17 persona. U hodhën poshtë akuzat për 3 persona, dhe hetimet janë ndërprerë për 9 persona; si dhe pas hetimeve janë paraqitur aktakuza kundër 5 personave. Në anën tjetër, në vitin 2015, rezultatet e prokurorisë në trajtimin e rasteve të pastrimit të parave ka qenë më të dobëta se në vitin e kaluar. Në vitin 2015, prokurori i shtetit ka zgjidhur vetëm 7 (shtatë) raste kundër 15 personave, ose 18%;</p> <p>6.4 (c) Gjatë muajit prill të vitit 2014, një vizitë vlerësimi është kryer në Njësinë për Intelegjencë Financiare (NJIF) nga tre shtete mbështetëse, të cilat janë anëtare të Grupit Egmont (rrjet joformal ndërkombëtar i njësive për inteligjencë financiare). Ekipi vlerësues ishte i kënaqur nga Departamenti për Hulumtim dhe Analiza Financiare dhe punën e tyre kundër Pastrimit të parave/financimit terrorizmit. Vizita çoi në përfundime që NJIF-i i përmbush standardet e Grupit Egmont. Në shkurt, Kosova paraqiti aplikimin e saj për anëtarësim në Grupin Egmont, sponsorizuar nga NJIF-të e Finlandës, Senegalit dhe Sllovenisë. Anëtarësimi i Kosovës është ende pezull. Sipas Koordinatorit Kombëtar Ekonomik, anëtarësimi i NJIF Kosovës në Grupin Egmont është ende pezull për shkak të disa</p> | <p>pastrimin e parave, ndjekjet penale dhe dënimet nga shërbimi prokurorial i Kosovës apo mekanizmat tjerë të autorizuar për të luftuar rastet e pastrimit të parave. Këto statistika duhet të publikohen rregullisht. Prokurori i Shtetit duhet të bëjnë përpjekje të mëtejshme në trajtimin e rasteve të pastrimit të parave, të cilat do të pasqyrohen në statistikat e tyre;</p> <p>6.4 (c) Megjithëse kanë kaluar dy vjet që kur Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF) ka aplikuar për anëtarësim në Grupin Egmont, anëtarësimi i saj është ende pezull; NJIF duhet t'i përmbushë vërejtjet e ekspertëve Grupit Egmont sa më shpejtë që të jetë e mundur, në mënyrë që të jetë anëtare e plotë në organizatën e lartpërmendur;</p> |
|--|--|--|--|

| | | | |
|--|--|--|---|
| | | <p>mangësive në fushën e financimit të terrorizmit shënuar në Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që u konstatuan nga ana e ekspertëve të Grupit Egmont;</p> <p>6.4 (d) Është shënuar progres në rekrutimin e stafit të nevojshëm të Njesisë për Intelgjencë Financiare, në mënyrë për t'iu përgjigjur të gjitha nevojave operacionale. Aktualisht janë 18 anëtarë të personelit, nga një total prej 20 personave. Për të arritur kapacitetin e plotë, propozimi i Drejtorit të NJIF-it për të punësuar 3 analistë më shumë është pranuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave;</p> <p>6.4 (e) Kur bëhet fjalë për rritjen e kapaciteteve të Njesisë për Intelgjencë Financiare (NJIF) dhe institucioneve të tjera që kanë të bëjnë me sektorin e pastrimit të parave, nga 1 maji deri më 31 korrik 2014, gjashtë zyrtarë të NJIF-it ndoqën shtatë trajnime me tema të tilla si: pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, krimet ekonomike, gjurmimi i aseteve, dhe ndihma juridike ndërkombëtare; Më tej, në tetor të vitit 2015, NJIF ka mbajtur një trajnim për Institucionet Mikro-financiare në Kosovë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit, i cili u organizua nga shoqata e institucioneve mikro-financiare (AMIK-ut);</p> <p>6.4 (f) Pavarësisht rëndësisë së trajnimeve adekuate për zyrtarët e Njesisë për Intelgjencë Financiare (NJIF), menaxhmenti i institucionit ka frikë që personeli i tyre tashmë i specializuar mund të largohet</p> | <p>6.4 (e) Edhe pse tashmë janë bërë përmirësime në lidhje me trajnimet, ka ende nevojë për të kryer kurse të tjera trajnimi për stafin e Njesisë për Intelgjencë Financiare (NJIF), sipas nevojës, në mënyrë që rezultati përfundimtar i punës së tyre të jetë shumë i kënaqshëm;</p> <p>6.4 (f) Njësia për Intelgjencë Financiare dhe institucionet relevante duhet të konsiderojnë mundësinë për të siguruar kushte më të mira pune për stafin e tyre, në mënyrë që të shmanget qarkullimi i stafit të aftë, rrjedhimisht dëmtimi i punës së tyre të përgjithshme si dhe rezultatet;</p> |
|--|--|--|---|

| | | | |
|---------------------------------------|---|--|--|
| | | nga puna për të kërkuar punë më fitimprurëse, për shembull në sektorin bankar. NJIF-i i Kosovës ka ndryshuar Procedurat Standarde Operative (PSO) dhe rregulloret e brendshme të saj, në bazë të rekomandimeve të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF); | |
| 6) Combating Money Laundering; | 6. 5. Duhet bërë vlerësimin e jashtëm dhe të brendshëm të kërcënimeve në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit; | 6.5 (a) Në qershor të vitit 2014, u zhvillua Vlerësimi Kombëtar i rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, i cili është i lidhur me sektorin e veçantë të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në sektorin e ndërtimit. Ky vlerësim i rrezikut është duke pritur miratimin e tij në periudhën e ardhshme raportuese. Plani i veprimit është hartuar në mënyrë paralele. Zbatimi i kësaj strategjie është duke u monitoruar nga Koordinatori Kombëtar për Ekonominë Joformale, Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, i cili u emërua në dhjetor të vitit 2013; | 6.5 (a) Vlerësimi i rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit duhet të miratohet menjëherë, në mënyrë që të përshpejtojë miratimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit; |
| 6) Combating Money Laundering; | 6. 6. Duke pasur parasysh natyrën e të dhënave të trajtuara nga Njësia për Intelgjencë Financiare (NJIF), sistemi i sigurisë së brendshme dhe jashtme duhet të përmirësohet; Organet e zbatimit të ligjit dhe institucionet gjyqësore duhet të përmirësojnë njohuritë e tyre lidhur me këtë lloj krimi që të jenë në gjendje për të trajtuar natyrën komplekse të krimit të pastrimit të parave; | 6.6 (a) Sa i përket sigurisë së Njesisë për Intelgjencë Financiare (NJIF), që nga viti 2011, objekti i NJIF-it është më i siguruar pasi që është blinduar dhe janë instaluar më shumë kamera sigurie; 6.6 (b) Sipas raportit vjetor të vitit 2013 të statistikave të harmonizuara (bazuar në mekanizmin përcjellës të zhvilluar nga Këshilli Prokurorial të Kosovës, në vitin 2013), në vitin 2013 ka pasur gjithsej 56 raste për vepra të pastrimit të parave, që kanë përfshirë 207 persona. Janë zgjidhur gjithsej 25 raste kundër 116 personave. Megjithatë, të dhënat mbi dënimet e fundit nuk | 6.6 (b) Ka përmirësime të vogla në lidhje me të dhënat e rasteve gjyqësore që kanë të bëjnë me krime të pastrimit të parave. Megjithatë, duhet të ketë edhe një databazë të të dhënave mbi dënimet përfundimtare në lidhje me krimet e pastrimit të parave, duke pasur parasysh se për momentin statistika të tilla nuk ekzistojnë; |

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>janë në dispozicion; Prej 39 rasteve, Prokuroritë, gjatë periudhës janar-qershor 2014, kanë zgjidhur 6 raste kundër 17 personave, si vijon: kanë rënë akuzat për 3 persona, janë mbyllur hetimet për 9 persona; si dhe pas hetimeve janë paraqitur aktakuza kundër 5 personave. Gjatë vitit 2015, nga një total prej 39 rasteve në punë të cilat përfshijnë 110 persona, Prokurori i Shtetit ka zgjidhur vetëm 7 raste me 15 persona ose 18%;</p> <p>6.6 (c) Në fillim të vitit 2013, është themeluar Instituti për Krime Ekonomike. Të gjitha institucionet e sundimit të ligjit marrin pjesë në këtë institut. Çdo institucion kërkon ato lloje të trajnimeve që ata i shohin si më të nevojshme për stafin e tyre. Njësia për Intelgjencë Financiare (NJIF), gjithashtu, merr pjesë dhe ka rolin kryesor në trajnimet për pastrimin e parave. Trajnimet për personelin e institucioneve për sundimin e ligjit zhvillohen dy herë në muaj në Vushtrri;</p> | <p>6.6 (c) Për shkak të kompleksitetit të krimeve ekonomike dhe financiare dhe pastrimit të parave, ekspertiza e gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit që punojnë në raste të tilla duhet të përmirësohet; Këshilli Prokurorial i Kosovës ka marrë tashmë hapat për emërimin e prokurorëve të specializuar për (në mesin e krimeve të tjera) krime ekonomike. Edhe pse, ky hap duhet të ndihmojë në luftën kundër krimeve të tilla, duke pasur parasysh se projekti është në fillimet e saj, kjo mund të marrë kohë para se këta prokurorë të specializohen. Prokuroria duhet t'u japë prioritet këtyre rasteve;</p> |
|--|--|--|--|

